

PROSPEKT

FOND I HAPUR INVESTIMI

WVP GLOBAL

Shoqëria për Administrimin e Fondeve të Investimit WVP Fund Management Tirana sh.a,
Rruga “Barrikadave”, Nr. 118, Kati 4, Ap. 1, 1001 Tiranë, Shqipëri
www.wvpfunds.al : contact@wvpfunds.al
tel: +355 4 22 24 525

Përmbajtje

I. TË DHËNA MBI FONDIN E HAPUR 6

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI FONDIN E HAPUR 6

1.1 Fondi WVP GLOBAL, Sipërmarrje Investimesh Kolektive me Ofertë Publike 6

1.2 Krijimi i Fondit dhe Kohëzgjatja 6

2. OBJEKTIVAT, POLITIKAT E INVESTIMIT DHE STRUKTURA E PLANIFIKUAR E PORTOFOLIT TË FONDIT TË HAPUR 7

2.1 Profili i Investitorit 7

2.2 Investimet e lejuara 8

2.3. Objektivat e Investimit dhe Struktura e Planifikuar e Portofolit 8

3. FAKTORËT E RREZIKUT TË INVESTIMIT NË FOND 13

3.1 Rreziku i tregut 14

3.2 Rreziku Operacional 15

3.3 Rreziku i Kredisë 15

3.4 Rreziku i Likuditetit 15

3.5 Rreziku i Kurseve të Këmbimit 15

3.6 Rreziku Rregullator 15

3.7 Rreziku i Inflacionit 15

3.8 Rreziku i Performancës 16

3.9 Rreziku Ligjor 16

3.10 Rreziku Politik 16

3.11 Rreziku i Reputacionit 16

3.12 Rreziku i Shlyerjeve te Mëdha 16

3.13 Rreziku i Palës Tjetër 16

3.14 Rreziku i Personelit Kyç 16

3.15 Rreziku i Mosdiversifikimit 16

3.16 Rreziku i Pezullimit të Shlyerjes së Kuotave 17

3.17 Rreziku i Agjencisë 17

3.18 Rreziku i Vlerësimit të Aseteve 17

3.19 Rreziku i Delegimit të Funksioneve 17

3.20 Rreziku i Depozitarit 17

4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT NË FOND 18

5. PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR BLERJEN E KUOTAVE 18

6. PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR SHLYERJEN E KUOTAVE 20

7. PROCEDURA DHE KOHA E PAGESËS SË KUOTAVE GJATË SHLYERJES SË TYRE 20

8. RRETHANA NGA TË CILAT MUND TË VIJË PEZULLIMI I SHITJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE 20

9. LIKUIDIMI DHE MBYLLJA E FONDIT 21
9.1 Bazat për likuidimin vullnetar dhe mbylljen 21
9.2 Kush e kryen procesin e likuidimit 21
9.3 Kërkesa për likuidimin vullnetar, procedurat dhe afati kohor për likuidimin e fondit 22
10. TARIFAT DHE KOMISIONET 22
11. LLOJET E PLANEVE INVESTUESE 24
11.1 Pagesë e Njëherëshme 24
11.2 Plani i Programuar 25
11.3 Plani i Kombinuar 26
11.4 Plani Investim + ... 26
11.5 Përjashtime nga Tarifa Hyrëse 27
11.6 Këmbimi i kuotave 27
11.7 Transferimi i pronësisë së kuotave në Fond 27
12. POLITIKA E SHPËRNDARJES DHE E PJESËMARRJES NË FITIMET E FONDIT 28
13. MËNYRA DHE PROCEDURA E INFORMIMIT TË MBAJTËSIT TË KUOTAVE 28
14. NJOFTIM MBI PERFORMANCËN DHE STRUKTURËN E FONDIT, VENDI DHE MËNYRA E PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT 29
15. TRAJTIMI FISKAL I FONDIT DHE MBAJTËSIT TË KUOTAVE 29
16. KOHËZGJATJA E VITIT FISKAL 29
II. INFORMACION MBI SHOQËRINË E ADMINISTRIMIT TË FONDEVE 29
17. FORMA LIGJORE 29
18. DATA E THEMELIMIT TË SHOQËRISË 29
19. KAPITALI I SHOQËRISË, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË 30
20. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE 30
20.1 Asambleja e aksionarëve 30
20.2 Këshilli i Administrimit 31
20.3 Personeli kyç i shoqërisë 32
21. INFORMACION MBI AKTIVITETET E SHOQËRISË 33
22. AUDITUESI 33
23. INFORMACION MBI DEPOZITARIN 33
24. DELEGIMI 35
III. INFORMACION PLOTËSUES 35
IV. FORMULARI TIP-KËRKESË PËR BLERJEN E KUOTAVE 37

Përkufizime

Në këtë prospekt, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

AMF: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

Asete: Titujt, instrumentet e tregut të parasë, instrumentet derivative, para dhe pasuri të tjera, në pronësi të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

Aksione: Aksionet ose kuotat e fondit të investimeve janë titujt, që krijojnë të drejta dhe detyrime, që lidhen me një pjesë të kapitalit të nje shoqërie aksionare ose të një fondi investimesh;

Bursë: Është një operator tregu, veprimtaria kryesore e të cilit është vënia në funksion e një tregu të rregulluar.

Depozitar: Një bankë e nivelit të dytë e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer shërbime të kujdestarisë, depozitimit dhe besimit dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për sipërmarrjet e investimeve kolektive;

Diversifikim i portofolit: Investim i aseteve të Fondit në instrumente të llojeve të ndryshme, me qëllim zvogëlimin e rreziqeve të lidhura me investimin;

Duration: Tregues i ndjeshmërisë së çmimit të një instrumenti me të ardhura fikse ndaj luhatshmërisë së normave të interesit. Duration përcakton ndryshimin e vlerës së një portofoli investimi kur normat e interesit luhaten me 1%. Zakonisht shprehet në numër vitesh;

Fond investimi: Është sipërmarrje e investimeve kolektive e themeluar me kontratë si grupim i veçantë aktivesh, me objekt të vetëm sigurimin e kapitalit nga investitorët dhe investimin e këtij kapitali në lloje të ndryshme investimesh, sipas një politike të miratuar për investimet, me qëllim realizimin e përfitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit të investimeve.

Investitor: Subjekti që ka në pronësi kuota në një fond investimi;

Këshilli i administrimit: Sipas ligjit për shoqëritë tregtare është i vetmi organ i shoqërisë administruese që ka kompetenca manaxhuese dhe mbikëqyrjeje (sistemi i drejtimit me një nivel);

Kuota: Është çdo pjesëmarrje e barabartë përpjesëtimore, që rezulton pas pjesëtimit të interesave përfitues në aktivet, objekt i sipërmarrjes së investimeve kolektive të fondit të investimeve.

Kuota akumulimi: Kuotat e një fondi, për të cilat të ardhurat nga investimi riinvestohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave;

Kthim nga investimi: Tregues i performancës së një fondi, i cili përcakton nëse investimi i aseteve të Fondit ka qenë efikas ose jo;

Menaxher i Investimeve: Personi përgjegjës në shoqërinë administruese për administrimin e portofolit të investimeve;

Ofertë publike: Ftesa për të blere kuota në fondin e investimit, e cila i drejtohet një numri të papërcaktuar personash, nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv.

Portofol: Tërësia e aseteve financiare të Fondit;

Prospekt: Dokumenti i bërë publik, i cili përmban informacion të rëndësishëm për sipërmarrjen e investimeve kolektive, si objektivat e investimit, rreziqet, tarifat etj;
WVP Fund Management Tirana sh.a: Shoqëri Administruese e fondit WVP Global në EURO;

Rating (vlerësim) i titujve të borxhit – renditja e titujve të borxhit e kryer nga agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit, sipas nivelit të riskut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi. Titujt e borxhit të klasifikuar me A, A2 dhe A3 përfaqësojnë një risk relativisht më të ulët dhe, për rrjedhojë, një kthim më të ulët nga investimi. Titujt e borxhit të klasifikuar me B, BB dhe BBB përfaqësojnë një risk mesatar, ndërsa titujt e borxhit të klasifikuar me C konsiderohen me risk të lartë dhe, për rrjedhojë, kanë një pritshmëri më të lartë për kthim nga investimi;

Rregullat e fondit: Dokumenti kryesor që rregullon marrëdhënien ligjore mes shoqërisë administruese dhe investitorit në një fond investimi;

Sipërmarrje investimesh kolektive (SIK): Personi juridik ose bashkimi i posaçëm i aseteve të investitorëve, që funksionon në formën e shoqërisë së investimit ose të fondit të investimit;

Shkëmbimi Automatik i Informacionit të Llogarive Financiare: Ligjin Nr. 4/2020 i miratuar nga Qeveria e R. së Shqipërisë për shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare ndërmjet autoriteteve tatimore të OECD dhe vendeve pjesëmarrëse. Informacioni për t'u shkëmbyer përfshin: balancat e llogarive financiare në fund të vitit që raportohet, fitimet kapitale (përfshirë interesat, dividendët, të drejtat dhe të ardhurat nga shitja e aseteve financiare) të raportuara te qeveritë nga institucionet financiare, duke mbuluar llogaritë e mbajtura nga individët dhe entitetet përfshirë trustet dhe fondacionet.

Hyrje

Prospekti në vetvete nuk përbën një ftesë për të blerë kuota të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat, rreziqet për të qënë pjesë e sipërmarrjes së investimeve kolektive

Informacioni i dhënë në këtë Prospekt është shprehur ndershmërisht, për të orientuar investitorët. Çdo opinion dhe parashikim i përmendur nuk ka për qëllim keq informimin e investitorit. Janë kryer të gjitha kërkimet e duhura për të konstatuar dhe verifikuar për sa më sipër.

Për çdo investitor është e këshillueshme të lexojë këtë prospekt përpara marrjes së vendimit për blerjen e kuotave në Fond, në mënyrë që të krijojë një ide të qartë mbi karakteristikat e Fondit dhe rreziqet e investimit në të.

I. TË DHËNA MBI FONDIN E HAPUR

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI FONDIN E HAPUR

1.1 Fondi WVP GLOBAL, Sipërmarrje Investimesh Kolektive me Ofertë Publike

Emri i fondit është: **WVP GLOBAL– Fond i hapur investimi;**

Fondi **WVP GLOBAL** është: Sipërmarrje e veçantë;

Emri i shkurtër i fondit është: **WVP GLOBAL**

Monedha bazë e fondit është: EURO

Fondi i investimit është një grupim i veçantë asetesh i paregjistruar si person juridik, i krijuar në bazë të një marrëdhënie kontraktuale, pas licencimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim: AMF) dhe i administruar nga një shoqëri administruese.
Kjo e fundit ka si veprimtari grumbullimin e aseteve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, asetet e të cilit investohen sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve në përputhje me ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", dhe mbajtësit e kuotave të cilët kanë të drejtën jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e Fondit, por gjithashtu të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre.
Blerja e kuotave nëpërmjet një oferte publike kryhet nëpërmjet pagesës së aseteve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt.
Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

Fondi i Investimit WVP GLOBAL është një sipërmarrje investimesh kolektive (SIK) me ofertë publike, i themeluar nga WVP FUND MANAGEMENT TIRANA sh.a, shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, e cila grumbullon asete monetare ose të ngjashme nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, dhe i administron ato me ndershmëri dhe profesionalizëm, në interesin më të mirë të investitorëve dhe të integritetit të tregut.

1.2 Krijimi i Fondit dhe Kohëzgjatja

Fondi u themelua me vendimin nr. 155, datë 23.10.2020 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
Fondi është themeluar për një afat të pacaktuar.

Depozitari i Fondit është **First Investment Bank – Albania sh.a**., me seli në Bulevardin "Deshmorët e Kombit", Twin Towers, Kulla 2, Kati 14.

Audituesi i jashtëm i Fondit është **Grant Thornton Albania** sh.p.k me seli në adresën: Rruga "Brigada 8", Pallati Nr.19, Kati 0, Nr.3, Tiranë, Shqipëri.
Personi përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të fondit do të jetë z. Kledian Kodra dhe znj. Esmeralda Gjomemo.

2. OBJEKTIVAT, POLITIKAT E INVESTIMIT DHE STRUKTURA E PLANIFIKUAR E PORTOFOLIT TË FONDIT TË HAPUR

Fondet e investimeve paraqesin mundësi për investimin e kapitalit, ku investitorët u besojnë asetet e tyre monetare institucioneve të specializuara – Shoqërive për administrimin e fondeve të investimit.
Asetet monetare grumbullohen nëpërmjet shitjes së kuotave në Fond, ndërsa Shoqëria të njëjta asete do t`i investojë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit, Prospektit dhe Rregullores së Fondit. Fondi është në pronësi të mbajtësve të kuotave. Mbajtësit e kuotave kanë të drejtë në pjesë proporcionale nga fitimet e fondit (kthimet), si dhe kanë të drejtë në çdo moment të kërkojnë shlyerjen e kuotave dhe në atë mënyrë të dalin prej fondit.

2.1 Profili i Investitorit

Si investitorë të Fondit mund të bëhen persona fizik të vendit dhe/ose të huaj, përveç shtetasve të SHBA-së, persona juridik të vendit dhe/ose të huaj, përveç shtetasve të SHBA-së, të cilët i konsiderojnë të përshtatshme objektivat e investimit të Fondit, dëshirojnë të investojnë në valutën EURO, synojnë një Fond likuid në çdo kohë dhe janë të përgatitur të marrin përsipër një shkallë të caktuar risku, kundrejt kthimeve të kënaqshme nga investimi.

Fondi u dedikohet të gjithë atyre klientëve të cilët dëshirojnë të investojnë në valutën EURO dhe të realizojnë fitime duke shfrytëzuar rritjen globale në ekonominë botërore, posaçërisht në ekonomitë më të zhvilluara në botë si SHBA, Gjermani dhe Zvicër. Fitimet do të realizohen nëpërmjet investimit të aseteve të fondit në kompani të mëdha të cilat janë lëvizëse të zhvillimit ekonomik dhe mbartëse të inovacioneve.
Nëpërmjet investimeve në fond klientët do të sigurojnë diversifikim të kapitalit të tyre dhe njëkohësisht do t`i realizojnë qëllimet e veta specifike financiare, gjithmonë duke pasur një nivel të lartë të likuiditetit.
Investitorë në fond, mund të jenë persona fizikë dhe juridikë të vendit dhe të huaj, përveç shtetasve të SHBA-së, motivi i të cilëve është rritja e kapitalit me shfrytëzimin e:

- Zhvillimit të vazhdueshëm dhe inovacionit të korporatave të njohura botërore - kompanitë “Large Caps”, të cilat paguajnë dividend të lartë, ku edhe në periudha të aktivitetit të zvogëluar ekonomik arrijnë rezultate pozitive;
- Stabilitetit dhe sigurisë të monedhës EURO;
- Administrimit profesional të aseteve të fondit;
- Mundësisë për të zvogëluar rrezikun e tregut nga blerja direkte e aksioneve (investimit në bursa);
- Mundësisë që të bëhen aksionarë indirekt në kompanitë më të njohura botërore;
- Ri-investimin automatik të fitimit (kthimit);
- Divesifikimi të portofolit sipas vendeve, valutave dhe instrumenteve;
- Mundësisë për ndjekje dhe qasje deri tek asetet e investuara në çdo moment;
- Ekspertizës dhe imazhit të krijuar nga Shoqëria për administrimin e fondeve.

Periudha kohore e cila rekomandohet nga Shoqëria për investim në Fond është së paku 10 (dhjetë) vjet, por likuiditeti dhe fleksibiliteti është i garantuar në çdo kohë.

Secili investitor potencial para nisjes së investimit do të duhet të përcaktojë objektivat e veta specifike financiare, të vlerësojë shkallën e pranueshme të rrezikut në të cilën mund të jetë i ekspozuar, të përcaktojë horizontin kohor të investimit dhe së fundi, të përcaktojë pritshmërinë e fitimeve të cilat dëshiron të realizojë në të ardhmen.

Asetet të cilat do të investohen rekomandohet që të jenë të lira dhe për qëllim diversifikimi. Zgjedhja e fondit duhet bërë bazuar ne përshtatshmërinë me interesat dhe objektivat e parashtruara.

Fondi WVP Global ka tregues sintetik të riskut 5, duke patur parasysh faktin që shumica e aseteve të fondit investohen në aksione të cilat tregtohen në bursa të rregulluara ndërkombëtare, ku ekziston rreziku i luahtshmërisë së çmimeve.

2.2 Investimet e lejuara

Sipas ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", portofoli i Fondit mund të përbëhet nga:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë së 12 muaj;
- instrumente financiare derivative;
- instrumente të tjerë të tregut të parasë.

Për secilin prej instrumenteve të mësipërm, shoqëria administruese angazhohet se do të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për administrimin e rrezikut.

2.3. Objektivat e Investimit dhe Struktura e Planifikuar e Portofolit

2.3.1 Objektivi i investimit

Objektivi i investimit të Fondit është realizimi i fitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit, duke investuar në parim në tituj të kompanive të mëdha në ekonomitë e zhvilluara botërore por në disa raste edhe tituj borxhesh dhe depozita bankare duke ruajtur nivel të lartë të likuiditetit.
Në këtë mënyrë mbajtësit e kuotave, në një afat më të gjatë kohor, do të mund të marrin pjesë në rritjen e ekonomisë botërore dhe të realizojnë fitime nga investimet e tyre.

2.3.2 Struktura e planifikuar e portofolit

Objektivi i investimit do të arrihet nëpërmjet administrimit profesional të aseteve të fondit, duke krijuar një portofol kryesisht të përqëndruar në aksione të kompanive të mëdha, që janë të listuara në bursat më të zhvilluara dhe më të rregulluara të botës dhe përqindje e vogël në tituj borxhesh të shteteve dhe korporatave.
Në fokus të politikës investuese të fondit, do të jenë kompanitë e mëdha – **"Large Caps",** të cilat janë udhëheqës në industritë e tyre dhe kanë histori të vazhdueshme rritëse të pagesës së dividendit kundrejt investitorëve.
Në procesin e investimit kujdes të madh do t`i dedikohet minimizimit të rreziqeve, duke shpërndarë riskun në shumë kompani, industri, rajone dhe valuta të ndryshme.

Asetet e fondit do të investohen në tituj të emetuesve, të cilët tregtohen në bursat e rregulluara në këto vende:

a) **SHTETET E BASHKIMIT EUROPIAN**
b) **SHBA – SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS**
c) **ZVICRA dhe SHTETE TË TJERA që janë anëtarë të Federatës Botërore të Bursave – WFE** - https://www.world-exchanges.org/

Shoqëria do të investojë mjetet e Fondit konform Ligjit për investimet e lejuara, kufizimin e investimeve dhe tejkalimin e kufizimeve për investime të aseteve së Fondit, në llojet e instrumenteve si vijon:

- **Aksione** – Aksione të shoqërive aksionare të tregtuara në bursat e shteteve të zhvilluara, që kanë likuiditet të lartë dhe janë pjesë e indekseve të shteteve ku operojnë, të cilat tregtohet në tregjet e rregulluara të shteteve në pikat: a), b), c) dhe në Republikën së Shqipërisë. Gjithashtu, do të konsiderohet investimi në aksione të shoqërive të tregtuara në Republikën e Shqipërisë në momentin që këto shoqëri do të listohen në një bursë të rregulluar të kësaj republike.
- **Tituj Borxhesh të Shteteve dhe Korporatave –** të cilat tregtohet në tregjet e rregulluara të shteteve në pikat: a), b), dhe c) dhe në Republikën e Shqipërisë.
- **Fondet e investimit** – kuota ose aksione të fondit të investimeve të regjistruara në shtetet e mësipërme në pikat: a), b), dhe c) dhe në Republikën së Shqipërisë.
- **Depozitat** – Depozitat në Bankat e Licencuara në Republikën e Shqipërisë, në afat kohor jo më të gjatë se një vit.
- **Instrumentet e tregut të parasë -** Investimet në Certifikata të Depozitave
- **Mjete monetare dhe ekuivalente (cash).**

Në çdo rast shoqëria administruese do të zbatojë kufizimet e përcaktuara nga neni 139 dhe 140 i ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe rregulloreve të AMF-së në lidhje me investimet dhe huamarrjen.

Fondi mund të investojë në fonde investimi, tarifa për administrim e të cilëve nuk tejkalon 2% nga vlera neto e aseteve të atij fondi në nivel vjetor. Deri më 100% të vlerës neto të Fondit mund të investohet në tituj/aksione të emetuesve veprimtaria e të cilëve, kryhet në territorin e vëndeve të Bashkimit Europian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zvicra dhe shtetet të tjera që janë anëtarë të federatës botërore të bursave – wfe - https://www.world-exchanges.org.

Shoqëria nuk planifikon të investojë në kuota të sipërmarrjeve të administruara nga e njëjta shoqëri administruese apo nga ndonjë shoqëri, subjekt ose person juridik me të cilin shoqëria administruese ka lidhje pronësie.

Në tabelën që vijon është paraqitur struktura e planifikuar e portofolit të Fondit:

Lloji i instrumentit	**Tregjet**	**Përqindje nga portofoli**
Aksione - Tituj	Shtetet e përmendura në pikat: a), b), dhe c) dhe Republikës së Shqipërisë.	Deri më 100%
Tituj Borxhesh të Shteteve dhe Korporatave *		Deri më 50 %
Fonde investimi**		Deri më 50%
Depozita Bankare, Certifikata të Depozitave, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	Republika e Shqipërisë	Deri më 75%

*Nuk do të tejkalohet më shumë se 35% e vlerës së aktiveve të sipërmarrjes në investimin në tituj të transferueshëm ose në instrumente të miratuara të tregut të parasë, të lëshuara ose të garantuara nga një shtet i vetëm, autoritet lokal ose organ publik ndërkombëtar.

** Nuk do investohen më shumë se 10 % të vlerës së sipërmarrjes në aksione ose kuota të një sipërmarrjeje të vetme. Tërësia e ekspozimeve nuk do tejkalojë 30 % nëse këto sipërmarrje nuk janë klasifikuar si SIKTT, në Republikën e Shqipërisë, ose (UCITS) në vendet e Bashkimit Europian.

Në procesin e administrimit të aseteve do të shfrytëzohen strategjitë si vijon:

- **Value Investing** (strategji për investim në kompani të shëndosha dhe fitimprurëse);
- **Event Driven Strategy** (strategji e themeluar në ndodhi specifike globale);

2.3.2 / 1 Benchmark i WVP GLOBAL:

Bordi i Investimit i WVP Fund Management ka vendosur Benchmarkun për WVP GLOBAL të jetë si më poshtë:

- 30 % Dow Jones Industrial Average Index
- 70 % Stoxx Europe 50 Index

2.3.2 / 2 Shpërndarja e Aseteve të Fondit

Në bazë të politikës investuese të aprovuar nga Bordi i Investimit, konform kufizimeve dhe dispozitave të Ligjit si dhe për t'u përshtatur Benchmarkut të vendosur nga Bordi i Investmit, asetet e fondit do të kenë një shpërndarje në Tregje, Valuta dhe Industri të ndryshme.

Shpërndarja e aseteve të WVP GLOBAL mund të jetë si më poshtë:

- Deri më 30 % në tregjet e rregulluara të SHBA në valutën USD
- Mbi 50 % në tregjet e rregulluara në BE – në valutën EUR
- Deri më 10% në tregjet e rregulluara në Zvicër – në valutën CHF
- Deri më 10% në tregjet e rregulluara në Britanin e Madhe – në valutën GBP
- Hapësirë prej 20 % në tregje dhe valuta të tjera të aprovuara nga AMF.

Shpërndarja sipas Industrive mund të jetë si vijon:

Industria:	**Rreth %**
Health Care / Shëndetsore	20
Financials / Financiare	20
Consumer Staples / Konsum i përditshëm	15
Industrials / Industriale	15
Consumer Discretionary / Konsum luksi	12
IT / Teknologjia e Informacionit	15
Energy / Energjisë	10
Telecom / Telekomunikimit	5
Real Estate / Pasuri e paluajtshme	5
Utilities / Shërbime të dobishme	5
Materials / Materiale Bazë	10

KUJDES: Shpërndarja e aseteve të Fondit nuk është fikse dhe ajo mund të hasi ndryshime në varësi të rrethanave ekonomike dhe politikës të investimit.

Investitorët duhet gjithmonë të kenë parasysh Strukturën e planifikuar të Portofolit në tabelën e paraqitur në pikën 2.3.2.

Investimi i aseteve të Fondit do të jetë konform dispozitave të Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Politika e investimit të Fondit mund të ndryshohet me vendim të Shoqërisë, ku për çdo ndryshim të propozuar shoqëria njofton paraprakisht Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Pas miratimit nga autoriteti, shoqëria njofton të gjithë mbajtësit e kuotave në mënyrat e përshkruara në pikën 13 të këtij Prospekti.


Investime në Instrumente Financiare Derivative

Investimet në instrumente financiare derivative mund të përdoren (në raste shumë të rralla) si mjet për shmangien e rreziqeve dhe për arritjen e objektivave të Investimit të Fondit. Në asnjë rrethanë, këto veprime nuk duhet të shkaktojnë ndryshim të objektivave të sipërmarrjes së investimeve kolektive siç përcaktohet në prospektin e SIK. Ekspozimi në instrumentet derviative nuk mund të tejkalojë nivelet e parashikuara në ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", dhe rregulloren nr. 106, datë 30.06.2021.

2.3.3 Të Dhëna Historike mbi të Ardhurat e Fondit

Fondi WVP Global ka filluar aktivitetin më 11.01.2021, prospekti i të cilit u miratua me Vendim Nr. 154, datë 23.10.2020. Gjatë vitit 2025 fondi ka rezultuar me një normë kthimi neto prej 7.49% dhe, nga fillimi i aktivitetit të tij dhe deri më 31 Dhjetor 2025, fondi ka rezultuar me një normë kthimi neto prej 63,84%. Performanca përfaqëson normën e kthimit neto mbasi janë zbritur të gjitha kostos dhe tarifat që i mbahen fondit.

Të dhënat historike mbi kthimet nga e kaluara kanë karakter informativ dhe nuk duhet të konsiderohen si garanci për të ardhmen.



2.3.4 Metoda dhe Frekuenca e Vlerësimit të Aseteve të Fondit dhe Çmimit për Kuotë

Shoqëria administruese llogarit vlerën totale të aseteve të Fondit, përcakton detyrimet e tij dhe llogarit vlerën neto të aseteve të Fondit si edhe vlerën neto të aseteve për kuotë. **Këto llogaritje bëhen në bazë ditore.**

Depozitari garanton që llogaritja e vlerës neto të kuotave në Fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, prospektin dhe rregullat e Fondit.

Metoda e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet konform dispozitave të Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", dhe rregulloren "Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të

investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion" e dalë në zbatim të tij, si edhe në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
Shoqëria dhe Depozitari kanë rënë dakord për të aplikuar metodologjinë e mëposhtme për llogaritjen e vlerës neto të aseteve të Fondit dhe çmimit të kuotës.

I. VLERËSIMI I LLOGARIVE RRJEDHËSE

Në lidhje llogaritë rrjedhëse, vlera e tyre e tregut në një moment të caktuar është e barabartë me gjëndjen e llogarisë në atë moment, plus interesat.

Llogaritja e interesit për llogaritë rrjedhëse të Fondit, kryhet në bazë ditore, ndërsa atribuimi i tyre bëhet në bazë mujore. Interesi fillon të llogaritet në datën kur Shoqëria Administruese dhe Depozitari kanë nënshkruar marrëveshjen për celjen e një llogarie rrjedhëse për Fondin.

Baza e llogaritjes së interesave është 365 ditë.

Depozitari kryen pagesën e interesave:

- në ditën e parë të punës të muajit pasardhës për muajin korent,
- ose në ditën e fundit të muajit korent (dita N) por pa përfshirë interesat e asaj dite.

II. VLERËSIMI I DEPOZITAVE ME AFAT

Llogaritja e të ardhurave nga interesi për depozitat me afat të Fondit do të kryhet në bazë ditore, ndërsa pagesa e tyre do të behet në ditën e maturimit të depozitës.

Baza e llogaritjes së interesit përcaktohet në bazë të monedhës dhe kontratës së lidhur me palën tjetër (360/365 ditë).

Interesi fillon të llogaritet në ditën e shlyerjes të transaksionit mes palëve.

Çdo depozitë me shlyerje datën T dhe maturim në datën N, do të gjenerojë interes nga data T deri në datën (N-1), ndërsa pagesa e interesit nga pala tjetër do të kryhet në datën N.

III. VLERËSIMI I TRANSAKSIONEVE ME TITUJ

Blerjet dhe shitjet e titujve, do të përfshihen në vlerësimin e aseteve Fondit në datën e tregtimit. Deri në datën e shlyerjes do të mbahen njëkohësisht në detyrime/arkëtime.

Vlerësimi i portofolit të titujve për tregtim (libri i tregtimit)

Portofoli i titujve për tregtim do të rivlerësohet çdo ditë pune. Për letrat me vlerë të tregtuara rregullisht në tregjet ndërkombëtare, çmimet do të merren nga Reuters. Si bazë vlerësimi do të përdoret oferta blerëse në mbyllje të tregjeve (çmimi i fundit i ofertës) Reuters. Nëse bursat ndërkombëtare janë të mbyllura, atëherë do merren për bazë çmimet e ditës së fundit që ato kanë qenë të hapura.

Për Bonot e Thesarit ose Obligacionet e emetuara në euro nga qeveria shqiptare, për të cilat nuk ka një treg aktiv, rivlerësimi bëhet në bazë të normës së tregut (rendimenti i tregut), e cila përllogaritet sipas ditëve të mbetura deri në maturim (YTM) dhe ankandeve të fundit të Bankës së Shqipërisë.

Çdo letër me vlerë e klasifikuar në portofolin për t'u tregtuar, do të regjistrohet me çmimin e blerjes dhe do të rivlerësohet me vlerën e tregut të po asaj dite.

Në rastet e blerjeve të letrave me vlere të emetuara në euro nga qeveria shqiptare, nga i njëjti ankand me çmime oferte të ndryshme, do të regjistrohen me çmimin e blerjes dhe do të rivlerësohen me rendimentin mesatar të ponderuar të ankandit.

Në fundjavë ose për çdo ditë pushimi zyrtar në Shqipëri, çmimet e instrumenteve do jenë të njejtë me ato të ditës së fundit të punës.

Pas rivlerësimit, portofoli i titujve në monedha të ndryshme do të konvertohet në EURO me kursin fiks të publikuar nga Banka e Shqipërisë për secilën monedhë.

IV. VLERËSIMI I KUOTAVE TË SIPËRMARRJEVE TË TJERA TË INVESTIMIT

Kuotat e sipërmarrjeve të tjera të investimit do të vlerësohen me vlerën neto të aseteve për kuotë të sipërmarrjes përkatëse, sipas publikimit (d.m.th vlera e kuotës e disponueshme në ditën e vlerësimit).

Në rastin kur vlera neto nuk është publikuar, ose nuk është në dispozicion në ditën e vlerësimit, vlera e drejtë e kuotës që shërbën si bazë llogaritje do të jetë çmimi më i fundit i publikuar për atë sipërmarrje nga shoqëria përkatëse e administrimit.

Ne rastin e Fondit të tregtuar në bursë, si bazë vlerësimi do të merret çmimi i fundit i ofertës nga Reuters.

Pas rivlerësimit, portofoli i kuotave do të konvertohet në monedhën EURO me kursin fiks të publikuar nga Banka e Shqipërisë për secilën monedhë.

Vlera e kuotës së Fondit në ditën e vlerësimit përcaktohet duke pjesëtuar vlerën neto të aseteve të Fondit në EURO, me numrin e përgjithshëm të kuotave për atë ditë. Ky numër përputhet me numrin e kuotave në ditën paraardhëse të vlerësimit duke i zbritur numrin e kuotave të shlyera në ditën e vlerësimit dhe duke i shtuar numrin e kuotave që Fondi ka emetuar, në ditën e vlerësimit.

Dita e vlerësimit të aseteve të Fondit (t-1) do të jetë një ditë para ditës (t) gjatë së cilës është llogaritur vlera neto e aseteve për kuotë.
Depozitari ka detyrimin që të informojë Autoritetin në lidhje me përllogaritjen e vlerës neto të aseteve të Fondit dhe çmimit për kuotë brenda ditës.

3. FAKTORËT E RREZIKUT TË INVESTIMIT NË FOND

Investimi në Fondin WVP GLOBAL i jep investitorit mundësi përfitimi, por në të njëjtën kohë riskun e humbjes nga investimi e mbart investitori.
Është e pamundur që rreziku të shmanget plotësisht, por ai mund të reduktohet duke zbatuar procedurat e duhura për administrimin e tij. Për këtë qëllim, shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një njësi të veçantë, përgjegjëse për kontrollin e të gjithë transaksioneve që kryhen në emër të Fondit. Veprimtaria e kësaj njësie së bashku me metodologjinë e administrimit të rrezikut janë të parashikuara në rregulloret dhe procedurat e brendshme të shoqërisë administruese.
Në momentin e vendimmarrjes për investime, shoqëria administruese trajton çdo investim të veçantë brenda kuadrit të rrezikut të përgjithshëm që rezulton nga totali i aseteve të Fondit, duke zbatuar parimet e sigurisë, likuiditetit dhe përfitueshmërisë.

FONDI MUND TË MOS JETË NJË INVESTIM I PËRSHTATSHËM PËR TË GJITHË INVESTITORËT.

Çdo investitor potencial në Fond duhet të gjykojë mbi përshtatshmërinë e investimit në funksion të kushteve dhe nevojave të tij specifike. Në veçanti, çdo investitor potencial duhet:

- Të ketë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të saktë të Fondit, të përfitimeve dhe rreziqeve nga investimi në Fond, si edhe të informacionit që përmban ky prospekt dhe çdo dokument tjetër që lidhet me Fondin;
- Të ketë njohuri për të vlerësuar siç duhet investimin në Fond, në përputhje me situatën e tij financiare, dhe ndikimin që Fondi do të ketë mbi totalin e portofolit të tij të investimeve;
- Të ketë likuiditet të mjaftueshëm dhe burime të tjera financiare për të përballuar të gjitha rreziqet që mund të vijnë nga investimi në Fond;
- Të kuptojë plotësisht kushtet e Fondit dhe funksionimin e tregjeve financiare; dhe
- Të jetë në gjendje të vlerësojë skenarë të mundshëm që lidhen me faktorë ekonomikë apo të tjerë, të cilët mund të ndikojnë në investimet e tij dhe në shkallën e rrezikut të marrë përsipër.

Fondi është i përshtatshëm për investitorët të cilët kanë një tolerancë mesatare ndaj rrezikut, megjithatë performanca e Fondit mund të cënohet në veçanti nga rreziqet e mëposhtme:

3.1 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut i referohet mundësisë së humbjes që vjen si rezultat i luhatjeve të çmimeve në tregjet financiare. Ky rrezik përfshin ndikimet që mund të vijnë nga ndryshimet në çmimet e instrumenteve financiare në të cilat investon fondi, përfshirë edhe instrumentet financiare derivative.
Aksionet - çmimi i të cilave mund të ndryshojë çdo ditë në bazë të gjykimit dhe kërkesë/ofertës të investitorëve në bursat ku ato listohen. Ulja e çmimit të titujve mund të sjellë uljen e vlerës së portofolit të Fondit si dhe e kundërta, rritja e çmimit të titujve mund të sjellë rritjen e vlerës së portofolit të Fondit.
Titujt e Borxhit të shteteve - Çmimi i titujve të borxhit ka një marrëdhënie inverse me yield-in e tyre. Kjo do të thotë se kur yield-i rritet, çmimi i titullit bie, dhe kur yield-i bie, çmimi i titullit rritet. Kjo ndikon në lëvizjen e çmimit të kuotës në fond, nëse këto tituj janë blerë për tregtim dhe tregtohen në treg të rregulluar.
Titujt e Borxhit të Korporatave - zakonisht janë të tregtuar në bursat e rregulluara dhe ndikohen nga zhvillimi i biznesit të korporatës. Nëse ka indikacione dhe pritshmëri të mira për biznesin në të ardhmen dhe investitorët janë të sigurt që do u rikthehet borxhi dhe interesi, atëherë ulet interesi i titullit të korporatës dhe rritet çmimi i obligacionit si dhe e kundërta. Në të dyja rastet, lëvizja e çmimit të titullit ndikon direkt në lëvizjen e çmimit të kuotës, në varësi të përqindjes të ekspozuar në portofolin e fondit.
Fondet e Investimit të Hapura - Vlerësohen në bazë ditore dhe çmimi i kuotës të tyre ndryshon varësisht nga portofoli i aseteve të fondit të cilat zakonisht tregtohen në tregjet e rregulluara.
Instrumente financiare derivative - mund të përdoren nga fondi në përputhje me rregulloret përkatëse të AMF-së, të cilat janë instrumente që bazohen në çmimin e një aktivi themelor (underlying). Këto instrumente mund të tregtohen në tregje të rregulluara ose jo, dhe janë zakonisht më të paqëndrueshëm në krahasim me instrumentet tradicionale.

Nëse fondi përdor instrumente derivative, rreziqet e mundshme shtesë përfshijnë:

- Uljen e çmimit të instrumentit bazë, që mund të sjellë humbje për fondin në varësi të ekspozimit ndaj këtij instrumenti.
- Rrezikun që humbjet potenciale të mos jenë lehtësisht të matshme ose të tejkalojnë vlerën e kolateralit të marrë si mbrojtje.
- Vështirësi në realizimin e transaksioneve me çmime të favorshme për shkak të mungesës së likuiditetit në treg për disa lloje derivativësh.

Me qëllim mbrojtjen nga rreziku i tregut dhe minimizimin e tij, Shoqëria do të operojë nëpërmjet diversifikimit të portofolit, konform me parimin e shpërndarjes së rrezikut.

Fondi WVP Global investon deri në 100% në aksione. Duke qenë se luhatshmëria e çmimit të aksioneve në tregjet ndërkombëtare ka qenë e lartë, WVP Global do te ndikohet nga kjo luhatshmëri . Nëse çmimi i aksioneve do të ulet investitori do të pësoje humbje si rrjedhojë e uljes së vlerës së portofolit të fondit si dhe anasjelltas.

3.2 Rreziku Operacional

Është rreziku i mundshëm i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerëzore ose keqfunksionime të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit. Për të shmangur këtë rrezik Shoqëria përveç që ka vendosur sistemet e kontrollit të brendshëm dhe procedura për të parandaluar rrezikun e humbjeve të Fondit nga gabimet njerëzore, program special për të ndaluar veprimet e shpejtuara, ka edhe Bankën Depozitare si kontrollues të investimeve, transaksioneve me investitorët dhe vlerësimit të aseteve. Kjo mundëson kontroll të dyfishtë dhe ulë rrezikun nga risku operacional.

3.3 Rreziku i Kredisë

Rreziku i kredisë paraqet mundësinë se emetuesi i ndonjë titulli të caktuar të mos jetë në gjëndje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij në momentin kur ato do të duhet të plotësohen. Mos plotësimi i detyrimeve nga ana e emetuesit të titujve do të kishte impakt negativ mbi vlerën e aseteve të Fondit.
Edhe kur instrumentet e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që rreziku i kredisë të përjashtohet plotësisht. Shoqëria do të minimizojë këtë rrezik në portfolin e Fondit, duke investuar në tituj borxhesh të qeverisë Shqiptare dhe shteteve ose korporatave me Rating të mirë.

3.4 Rreziku i Likuditetit

Ky rrezik lidhet me mundësinë që një aset financiar të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafërt me vlerën e tregut. Pavarësisht objektivit të Fondit për të krijuar një portofol të përbërë kryesisht nga tituj që kanë një treg sekondar aktiv, shitja e një titulli të caktuar, në momentin e kërkuar, mund të bëhet problematik.
Për të menaxhuar këtë rrezik, fondi do të investojë në instrumenta financiare të listuara dhe të tregtuara në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, të cilat konsiderohen si aktive (asete financiare) likuide me cilësi të lartë.

3.5 Rreziku i Kurseve të Këmbimit

Rreziku nga kurset e këmbimit paraqet formë të rrezikut e cila paraqitet gjatë ndryshimit të çmimit të një valute në raport me tjetrën. Fondi në portofolin e vet zotëron kryesisht tituj në valutën EURO por edhe tituj në valuta të ndryshme si USD, CHF, GBP, etj. Ndryshimet e mundshme të këtyre valutave në raport me valutën EURO mund të çojnë në rritje ose zvogëlim të vlerës së kuotave. Këtë rrezik Shoqëria do ta reduktojë me shpërndarjen e portofolit në valuta të huaja të ndryshme, duke tentuar të ulë efektin nga lëvizjet e mëdha të valutave botërore.

KUJDES: Fondi WVP GLOBAL është në EURO dhe çdo ndryshim valutor në bazë ditore mund të çojë në zvogëlim ose rritje të vlerës së kuotave.

3.6 Rreziku Rregullator

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator. Ky rrezik nënkupton ndryshimet rregullatore që rregullojnë fondet e investimeve nga ana e autoritetit rregullues.

3.7 Rreziku i Inflacionit

I quajtur ndryshe rreziku i fuqisë blerëse, ky është rreziku ku ndryshimet në të ardhurat reale të një investitori pasi i ka përshtatur ato me nivelin e inflacionit të jenë negative.
Ky rrezik tregon se norma e inflacionit tejkalon normën e kthimit nga investimi. Si rrjedhim, investitori mund të pësojë realisht humbje edhe pse mund të ketë patur fitim në terma absolute.

3.8 Rreziku i Performancës

Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

3.9 Rreziku Ligjor

Rreziku ligjor i referohet riskut të humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia e shoqërisë administruese për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë.

3.10 Rreziku Politik

Krizat politike mund të sjellin përkeqësim të aftësive paguese të Shtetit Shqiptar ose të shteteve të tjera ku Fondi do të investojë në tituj borxhesh dhe për rrjedhojë të ndikojë dhe në aftësinë paguese te investitorëve në Fond, duke ulur vlerën e aseteve të Fondit negativisht.

3.11 Rreziku i Reputacionit

Rreziku i reputacionit mund të dëmtojë emrin e mirë të Shoqërisë Administruese apo grupit ku ajo bën pjesë. Ky rrezik mund të vijë nga sjellja e Shoqërsisë Administruese apo e punonjësve te saj. Shoqëria ka hartuar rregulloren e brendshme të saj dhe kodin e punës nëpermjet të cilës janë shprehur qartë rregullat për komunikimin dhe transaparencën me klientët, të cilat garantojnë mirëmbajtjen e reputacionit dhe integritetit të Shoqërisë Administruese.

3.12 Rreziku i Shlyerjeve te Mëdha

Shlyerjet e mëdha mund të vendosin në vështirësi Fondin, nëse do i duhet të kryejë shitje të një pjese të madhe të portofolit. Shitjet e detyrueshme në vlera të mëdha kryhen me çmime të pafavorshme sidomos për titujt e borxheve, të cilat mund të sjellin humbje për Fondin. Shoqëria do të investojë një përqindje të ulët në tituj borxhesh për të shmangur këtë rrezik dhe do të investojë në instrumente financiare me likuidet të lartë.

3.13 Rreziku i Palës Tjetër

Shoqëria Administruese në emër të fondit kryen transaksione ose transferta me palë të tjera, të cilat mund të mos kryhen apo të kryhen me vonesë si pasojë e mos zbatimit të kushteve të marrëveshjes mes palëve.

3.14 Rreziku i Personelit Kyç

Administratorët e Shoqërisë Administruese dhe menaxherët e portofolit janë kryesisht përgjegjës për performancën e Fondit e cila varet nga aftësitë profesionale të tyre, vendimarrja e duhur dhe absolute e veprimeve te tyre. Stafi i Shoqërisë Administruese mund të ndryshojë duke sjellë vështirësi në vijueshmërinë e aktivitetit. Për këtë Shoqëria si pjesë e një grupi financiar që vepron në 10 shtete të Europës ka vendosur sisteme mbrojtje edhe në raste të humbjes të personelit kyç lokal, për të vazhduar aktivitetin.

3.15 Rreziku i Mosdiversifikimit

Për të menaxhuar këtë rrezik, fondi synon të diversifikojë portofolin e tij duke investuar në një gamë të gjerë instrumentesh financiare, përfshirë aksione, tituj borxhi dhe depozita bankare. Megjithatë, në përputhje me nenin 140 të ligjit nr. 56/2020 'Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive', fondi mund të investojë në tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë të emetuara nga i njëjti subjekt, duke marrë parasysh kufizimet dhe përjashtimet e lejuara nga ligji. Këto masa synojnë të balancojnë nevojën për diversifikim me mundësitë për kthime të favorshme nga investimet e përqendruara.

3.16 Rreziku i Pezullimit të Shlyerjes së Kuotave

Investitori mund të kërkojë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tij. Por në përputhje me rregulloren nr. 189, datë 16.12.2020 "Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve", Shoqëria mund të pezullojë shlyerjen e kuotave në rrethana të jashtëzakonshme siç mund të jenë: a) ngjarje politike, ekonomike, ushtarake, ngjarjet e politikës monetare ose sociale, etj., në ndikimin e të cilave vlerësimi, blerja apo shitja e aseteve të Fondit nuk është e mundur të kryhet siç do kryhej në kushte normale; b) situata e krizave financiare që cojnë në mbylljen e tregjeve financiare; c) ndërprerja apo prishja për arsye madhore e mjeteve të zakonshme të komunikimit; d) raste të tjera të gjykuara nga AMF si të nevojshme për të mbrojtur interesat e mbajtësve të kuotave në Fond.

3.17 Rreziku i Agjencisë

Rreziku i agjencisë ndodh kur administratorët e Shoqërisë Administruese apo dhe menaxherët e portofolit nuk marrin vendim për rritjen e fitimit afatgjatë të Shoqërisë Administruese apo në shërbim të klientit, por nisen nga synimet e tyre personale afatshkurtra.
Shoqëria ka rregulloren e brendshme tek e cila janë vendosur rregulla mbi sjelljet e menaxherëve të portofolit dhe administratorëve të shoqërisë. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon procesin e investimeve dhe të transaksioneve te investitorëve dhe përbën një element të rëndësishëm kontrolli.

3.18 Rreziku i Vlerësimit të Aseteve

Investimet në tregje jo likuide si ai i bonove dhe obligacioneve të shtetit Shqiptar, vështirëson vlerësimin e këtyre aseteve duke mos patur mundësi gjetjen e çmimit direkt në këto tregje. Përdorimi I metodologjive për vlerësimin e aseteve jo likuide, shoqërohet gjithmonë me vështirësi nëse do të duhej kryerja e shitjeve të tyre, pasi këto metodologji përmbajnë element subjektiv që përafrojnë me vlerën e drejtë të asetit. Fondi planifikon të blej tituj borxhesh mundësisht që janë të tregtuara në bursat si ajo e Shqipërisë -ALSE ose bursa ndërkombëtare ku shteti Shqiptarë dhe shtetet e tjera i listojnë titujt e borxheve nga huazimet jashtë vendit.

3.19 Rreziku i Delegimit të Funksioneve

Disa funksione mund t'u delegohen palëve të treta, si për shembull shitja. Kjo veprimtari mund të gjenerojë risk në mënyrën se si kryhet si proces dhe, është shoqëria administruese ajo e cila mban përgjegjësinë finale ligjore mbi funksionet e deleguara.

3.20 Rreziku i Depozitarit

Funksioni i depozitarit duhet të kryhet nga një shoqëri e licencuar nga Autoriteti I Mbikëqyrjes Financiare. Në rast se kjo shoqëri nuk përmbushë detyrimet e saj ligjore, disa aktivitete të fondit, si për shembull përllogaritja e çmimit ditor të kuotës mund të vonohet dhe, për rrjedhojë edhe shpallja publike në faqen zyrtare të shoqërisë do të vonohet.

Shënim i rëndësishëm: Çdo investim në Fond, nuk konsiderohet si depozitë bankare, dhe si i tillë nuk sigurohet nga Agjensia e Sigurimit të Depozitave!

Megjithëse Fondi synon ruajtjen e kapitalit, ekziston mundësia e humbjes nga investimi në Fond.

4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT NË FOND

Në momentin e blerjes të kuotave në fond, çdo investitori do ti lëshohet nëpërmjet postës elektronike Certifikata për kryerjen e transaksionit e cila vërteton pronësinë mbi kuotat.

Ajo përmban: datën e blerjes së kuotave, emërtimin e fondit, emrin dhe selinë e regjistruar të shoqërisë administruese, numrin e kuotave të blera, emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të kuotave, vendin dhe datën e lëshimit të certifikatës, si dhe kredencialet për të hyrë në profilin personal të investitorit në sistemin online të shoqërisë.

Certifikata lëshohet nëpërmjet dërgesës postare vetëm në rast të kërkesës nga Investitori brenda 7 ditëve kalendarike nga data e mbërritjes së kërkesës.

Të drejtat që lidhen me pronësinë e kuotave në Fond janë:

• E drejta për informacion (raporte vjetore, gjashtë mujore etj);
• E drejta për të marrë pjesë proporcionale në fitimet e Fondit;
• E drejta për të shitur kuotat në çdo kohë;
• E drejta e transferimit të pronësisë së kuotave;
• E drejta për t'i këmbyer kuotat;
• E drejta për pronësinë dhe pajisjes me certifikatën e pronësisë;
• E drejta që asetet e Fondit, në rast falimenti të shoqërisë administruese ose të depozitarit, të jenë objekt i së drejtës së ndarjes.

Këto asete nuk do të përfshihen në asetet e shoqërisë administruese ose të depozitarit gjatë procedurave të likuidimit ose të falimentimit, dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj tyre. Në lidhje me detyrimet që lindin nga kuotat, mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

5. PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR BLERJEN E KUOTAVE

Shoqëria për administrimin e fondeve të investimit, pas licencimit nga AMF për themelimin e Fondit lëshon kuotat në Fond.
Me plotësimin e Formularit KËRKESË PËR BLERJE KUOTASH në WVP GLOBAL(në tekstin në vijim: Kërkesa) çdo person fizik ose juridik mund të blejë kuota në Fond. Kërkesa për blerje plotësohet në formular të veçantë të përgatitur nga Shoqëria.

Formularët mund të merren dhe plotësohen çdo ditë pune në zyrat e Shoqërisë ose jashtë saj nëpërmjet personave të autorizuar për shitjen e kuotave dhe në webfaqen e Shoqërisë www.wvpfunds.al .

Së bashku me dorëzimin e Kërkesës për blerje, pala – person fizik duhet te dorëzojë edhe një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë).
Gjatë dorëzimit të Kërkesës për blerje, pala – person juridik, duhet të dorëzojë dokumentacionin konform rregullave ligjore, si Ekstrat nga QKR ose dokument tjetër të lëshuar nga organet kompetente dhe kartë identiteti të përfaqësuesit ligjor të personit juridik.

Në qoftë se gjatë Kërkesës për blerje, pala, person fizik ose juridik, paraqitet nëpërmjet të autorizuarit, bashkëngjitur me Kërkesën për blerje do të bashkëngjisë edhe kopje të autorizimit të vërtetuar në noter (prokurë) e cila duhet të theksojë se autorizimi ka të bëjë me blerje të kuotave.

Në raste të caktuara specifike (kur pala është e mitur ose person të cilit i është kufizuar pjesërisht ose tërësisht zotësia e veprimit), Kërkesa për blerje të kuotave e dorëzon përfaqësuesi ligjor (prindi, kujdestari, adoptuesi) i personit të mitur ose personit të cilit pjesërisht ose tërësisht i është kufizuar zotësia e veprimit.

Të dhënat personale grumbullohen, përpunohen dhe përdoren nga ana e Shoqërisë, vetëm konform objektivave të përcaktuara me Ligj, Prospektit dhe Rregullores së Fondit, si dhe në përputhje me Ligjin dhe rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

Blerja e kuotave në Fond kryhet vetëm nëpërmjet pagesës së aseteve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt.

Çdo pagesë për blerje kuotash kryhet në llogarinë bankare të Fondit me nr**. AL94 2151 1031 EUR1 0000 1490 8100**, të hapur pranë depozitarit, i cili është First Investment Bank - Albania, sh.a në një nga mënyrat e mëposhtme:

• Pagesë cash direkt në sportelet e Bankës First Investment Bank – Albania, sh.a;

• Transfertë nga llogaria e investitorit pranë çdo banke të nivelit të dytë drejt llogarisë së Fondit.

Ky transaksion është subjekt i komisioneve bankare për transfertat të aplikuara si nga Banka ku investitori ka llogarinë ashtu edhe nga Banka Depozitare.

Çdo investitor që dëshiron të blejë kuota në Fond, do të nënshkruajë një kërkesë blerjeje dhe do të bëhet mbajtësi një numri të caktuar kuotash në momentin që kryen pagesën në favor të llogarisë së Fondit. Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në Fond, i llogaritur në përputhje me ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", rregulloret në zbatim të tij, si dhe në përputhje me këtë prospekt.

Numri i kuotave në Fond përcaktohet me 4 shifra pas presjes dhjetore.

Në rastet kur investitori nuk jep informacionin e duhur, në përputhje me rregulloret e brendshme ose ligjet përkatëse, ose kur ai paraqet një informacion të rremë, WVP Fund Management Tirana ka të drejtë të refuzojë kërkesën (urdhërin) për blerjen e kuotave, plotësisht ose pjesërisht.

Në qoftë se investitori kryen pagesën për blerjen e kuotave gjatë ditës (t), atëhere ai blen kuota sipas vlerës së kuotës në ditën e ardhjes së pagesës në llogarinë e Fondit.

Nëse kërkesa për blerjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste zyrtare, çmimi i blerjes së kuotave do të jetë ai i ditës së parë pasardhëse të punës.

Vërtetimi për blerjen dhe gjëndjen e kuotave, pa marrë parasysh se si janë fituar lëshohet nga ana e Shoqërisë, me kërkesë të investitorit jo më vonë se 5 ditë nga kryerja e pagesës në Fond.

Për kuotat e blera mbahet evidencë në formë elektronike nga Shoqëria dhe banka Depozitare.

Asnjë kuotë nuk mund të shitet ose të shlyhet me çmim tjeter përveç çmimit të ardhshëm të llogaritur pas marrjes së urdhërit për blerjen ose shitjen e kuotave.

6. PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR SHLYERJEN E KUOTAVE

Secili pronar i kuotave të Fondit ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e një numri të caktuar ose të gjithë kuotave të cilat ai zotëron dhe në këtë mënyrë të dalë nga Fondi.

Vlera e çdo kuote shlyhet pa tarifë dalje.

Mbajtësit e kuotave në çdo kohë mund të parashtrojnë Kërkesë për shlyerjen e të gjithë kuotave ose një pjesë të tyre. Kërkesa për shlyerjen e kuotave plotësohet nëpërmjet një formulari të veçantë të përgatitur nga Shoqëria, ku mund të merret në zyrat e Shoqërisë, në webfaqen e Shoqërisë www.wvpfunds.al si dhe nëpërmjet rrjetit shitës të krijuar nëpërmjet agjenteve shitës.

Gjatë dorëzimit të kërkesës për shlyerje, pala detyrimisht legjitimohet nëpërmjet dokumentacionit përkatës. Personat fizikë legjitimohen nëpërmjet dokumentit për identifikim personal (kartë identiteti ose pasaportë). Në qoftë se bëhet fjalë për person juridik, legjitimimi bëhet me dorëzimin e dokumentacionit përkatës (ekstrakt nga QKR, Fotokopje Nipt-i) si dhe kartën e identitetit të përfaqësuesit ligjor të personit juridik.

Në qoftë se investitori paraqet kërkesën për shlyerjen e kuotave gjatë ditës (t), atëhere ai shlyen kuota sipas vlerës së kuotës në ditën e mbërritjes së kërkesës së vlefshme për shitje.

Nëse kërkesa për shitjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste, dita e kërkesës së vlefshme për shitje do të jetë dita e parë pasardhëse e punës.

Vërtetimi për shlyerjen e kuotave lëshohet nga ana e Shoqërisë, me kërkesë të investitorit jo më vonë se 5 ditë nga kryerja e pagesës në Fond.
Për kuotat e shlyera mbahet evidencë në formë elektronike nga Shoqëria dhe banka Depozitare.

Në çdo rast e ardhura nga investimi do te jetë subjekt i tatimit sipas dispozitave të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat.

7. PROCEDURA DHE KOHA E PAGESËS SË KUOTAVE GJATË SHLYERJES SË TYRE

Në bazë të Kërkesës së parashtruar për shlyerje nga ana e mbajtësit të kuotave, Shoqëria jep urdhër deri tek banka depozitare, e cila kryen pagesën e vlerës së përcaktuar në llogarinë bankare të mbajtësit të kuotave, të përcaktuar në formularin e Kërkesës për shlyerje.

Shoqëria është e detyruar që të kryejë pagesën e për kuotat e shlyera nga Fondi jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas pranimit të Kërkesës për shlyerje.

8. RRETHANA NGA TË CILAT MUND TË VIJË PEZULLIMI I SHITJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE

Shitja dhe shlyerja e kuotave të Fondit mund të pezullohet në rastet kur:

- Shoqëria administruese dhe depozitari vlerësojnë se në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme ka arsye të forta e te justifikuara, për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, për të mbrojtur interesat e mbajtësve të kuotave të fondit. Çdo pezullim i shitjes dhe shlyerjes së kuotave i njoftohet menjëherë AMF-së. AMF, pas marrjes së njoftimit mund

të urdhërojë shoqërinë administruese për të rifilluar shitjen dhe shlyerjen e kuotave nese gjykon se është në interes të mbajtësve të kuotave. Shoqëria administruese publikon informacionin mbi arsyet e pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqe e saj të internetit, në mënyrë që mbajtësit e kuotave të kenë të gjithë informacionin e duhur në lidhje me këtë pezullim

- Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes merr fund sapo të përfundojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, por jo më vonë se brenda njëzet ditëve pune nga pezullimi, me përjashtim të rastit kur autoriteti ka dhënë pëlqimin me shkrim për shtyrjen e këtij afati. Rifillimi i veprimtarisë tregtare të Fondit publikohet në një gazetë të përditshme, në qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese.
- Gjatë periudhës kur nuk ka shoqëri administruese ose depozitar, apo kur shoqëria administruese ose depozitari vendoset në likuidim ose shpallet e falimentuar ose hyn në procedurë likuidimi ose është objekt i procedurave të ngjashme
- AMF vlerëson se nëse ka arsye për të besuar se është e nevojshme në interes të mbrojtjes së mbajtësve të kuotave ose në rastet e forcës madhore, urdhëron shoqërinë administruese dhe depozitarin që të pezullojë shitjen dhe shlyerjen e kuotave. Pezullimi mund të jetë me afat të caktuar ose pa afat.

Rifillimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave kryhet menjëhere sapo të pushojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes**.**

9. LIKUIDIMI DHE MBYLLJA E FONDIT

9.1 Bazat për likuidimin vullnetar dhe mbylljen e fondit

Shoqëria administruese mund të nis likuidimin e Fondit, kur krijohen rrethanat e parashikuara në ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

1. Fondi i investimeve me ofertë publike, i cili ka aftësi paguese, mund të likuidohet në mënyrë vullnetare:

a) në rast të shfaqjes së rrethanave të prishjes dhe likuidimit, të përcaktuara në aktin themelues të fondit të investimeve;

b) nëse shoqëria administruese bën kërkesë për likuidim, sepse fondi i investimeve nuk është ekonomikisht i qëndrueshëm dhe nuk përmbush qëllimin e tij;

c) në rast të përfundimit të detyrave të depozitarit ose shoqërisë administruese të fondit të investimeve, nëse ato nuk zëvendësohen brenda 60 ditëve pune;

ç) në rast të falimentimit të shoqërisë administruese;

2. Fondi i investimeve me ofertë publike likuidohet në momentin e heqjes të licencës nga autoriteti

9.2 Kush e kryen procesin e likuidimit?

Likuidimi i Fondit të investimit realizohet nga shoqëria administruese që administron Fondin. Në rastet kur kjo shoqëri i është nënshtruar procedurave të falimentimit ose kur AMF ka pezulluar përkohësisht ose ka hequr në mënyrë të përhershme licencën e saj, atëherë mbyllja realizohet nga depozitari i Fondit.
Nëse depozitari është duke ju nënshtruar procedurave të falimentimit ose kur licenca e tij si depozitar apo si bankë është pezulluar përkohësisht apo është hequr në mënyrë të përhershme, mbyllja e Fondit do të realizohet nga një likuidues fondi, i caktuar nga AMF.

9.3 Kërkesa për likuidimin vullnetar, procedurat dhe afati kohor për likuidimin e fondit

Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve i paraqitet autoritetit, jo më pak se 3 muaj, përpara datës së propozuar të likuidimit, në të cilën deklarohen arsyet e kërkesës dhe nje plan kohor për likuidimin.

Përpara njoftimit në autoritetit mbi likuidimin vullnetar të fondit të investimeve, shoqëria administruese harton një pasqyrë të audituar, ku konfirmohet se fondi është në gjendje t'i përmbushë të gjitha detyrimet brenda 12 muajve, prej datës së hartimit të pasqyrës të aftësisë paguese.

Shoqëria informon mbajtësit e kuotave, lidhur me likuidimin vullnetar pas dhënies së miratimit nga autoriteti. Informacioni që u vihet në dispozicion perfshin:

- Arsyet e likuidimit;
- Pasojat e mundshme për mbajtësit e kuotave
- Kostot përkatëse
- Pasqyrat e aftësisë paguese;
- datën e planifikuar të përfundimit të likuidimit vullnetar, përfshirë datën kur mbajtësit e kuotave do të kenë pagesën e vlerës së aksioneve ose kuotave.

Gjatë procesit të likuidimit të fondit të investimit, do të zbatohen procedurat e mëposhtme:

- njoftimi i mbylljes ose likuidimit vullnetar u dërgohet menjëherë mbajtësve të kuotave nëse nuk është bërë ky njoftim;
- ndërpritet vlerësimi dhe vendosja e çmimit;
- fondi i investimeve pushon së emetuari ose anuluari kuota, me përjashtim të anulimit përfundimtar;
- nuk regjistrohet asnjë transferim kuote dhe asnjë ndryshim nuk mund të bëhet në regjistrin e mbajtësve të kuotave;
- fondi i investimeve nuk ushtron asnjë lloj veprimtarie, me përjashtim të veprimtarisë së mbylljes;
- përgjegjësitë dhe detyrimet e shoqërisë administruese vijojnë të zbatohen deri në përfundim të mbylljes.

Gjatë periudhës së likuidimit vullnetar, shoqëria administruese vijon të hartojë dhe të publikojë raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme, dhe u mundëson këto raporte mbajtësve të kuotave.
Në përfundim të likuidimit vullnetar, periudha ushtrimore kontabël aktuale konsiderohet si periudha kontabël vjetore përfundimtare.
Brenda 4 muajve pas përfundimit të periudhës kontabël vjetore përfundimtare, raporti dhe pasqyrat financiare përfundimtare të audituara të fondit të investimeve publikohen dhe u dërgohen mbajtësve të kuotave të fondit të investimeve, si dhe autoritetit.

10. TARIFAT DHE KOMISIONET

10.1 KOMISIONE/TARIFA QË PAGUHEN NGA INVESTITORI

a. Tarifa e Hyrjes

Shoqëria administruese do të ngarkojë investitorin me tarifën e hyrjes në momentin e blerjes së kuotave dhe e njëjta vlere i zbritet nga shuma e investimit të parë.

Tarifa e hyrjes do të përcaktohet sipas shkallës të paraqitur në tabelën në vijim:

Shuma (EUR)	Tarifa e hyrjes (%)
Deri 14.999	5%
15.000-24.999	4,5%
25.000-49.999	4%
50.000-99.999	3,5%
100.000-249.999	3%
250.000-499.999	2,5%
500.000-999.999	2%
1.000.000-2.499.999	1,5%
Mbi 2.500.000	1%

Në rastin kur klienti ka asete në fond, për pagesat e ardhshme përqindja e tarifës së hyrjes do të përcaktohet duke mbledhur shumën e planit ekzistues me planin e ri investues.
Planet e pagesave janë të sqaruara më poshtë në pikën 11.1, 11.2, 11.3 dhe 11.4.

Në rast se Investitori bën kërkesë për këmbimin e kuotave, nga një fond në një fond tjetër të administruar nga Shoqëria, atëherë nuk do të bëhet ndërprerja e planit ekzistues.

b. Tarifa e daljes

Shoqëria nuk do të aplikojë tarifë për shlyerjen e kuotave.

10.2 KOMISIONE/TARIFA QË PAGUHEN NGA ASETET E FONDIT

a. Tarifa për Administrimin e Fondit

Tarifat që do t'u ngarkohen mbajtësve të kuotave në Fond do të jetë 2% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit.

Tarifa për administrimin e fondit llogaritet në bazë të vlerës neto të Fondit sipas formulës në vijim:

2% / 365

b. Tarifat dhe Kostot, që i Paguhen Depozitarit

Të gjitha tarifat dhe kostot e depozitarit/kujdestarit për shërbimet të cilat janë përcaktuar në kontratën e lidhur midis shoqërisë administruese dhe bankës depozitare do t'i ngarkohen Fondit.

Gjithashtu, nga asetet e Fondit, Shoqëria i paguan bankës depozitare kostot për bankën nën-depozitare. Shuma e këtyre kostove është e barabartë me kostot reale.

c. Kostot, Komisionet për Shitblerjen e Aseteve

Këto kosto përmbajnë të gjitha kostot e lidhura me blerjen dhe shitjen e pronës së fondit p.sh.: kostot për komisionet e broker-it, tarifat e bursës, tarifa për Depozitarin qëndror të titujve, tatime dhe kosto të tjera të mundshme të lidhura me barazimin e transaksioneve. Shuma e këtyre kostove është në nivel të kostove reale që dalin nga kontratat, referuar listave të tarifave të institucioneve përkatëse, të cilat do përfshihen në llogari të Fondit.

*d. Kosto p*ër auditimin vjetor

Shpërblimi për auditorin është e përcaktuar në kontratë e lidhur midis shoqërisë administrue dhe shoqërisë audituese, e cila aprovohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

dh. Tarifat rregullatore

Të gjitha tarifat që i paguhen Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për Fondin, do t'i ngarkohen aseteve të fondit.

*e . Kostot e komunikimit t*ë ndryshimeve në prospekt

*f. Kostot e e p*ërgatitjes, të shtypjes dhe tarifat postare për raportet vjetore për mbajtësit e kuotave

Kostot totale që paguhen nga asetet e Fondit, nuk do të tejkalojnë 3 % në vit të vlerës neto të aseteve të fondit (NAV).

11. LLOJET E PLANEVE INVESTUESE

11.1 Pagesë e Njëhershme

Kur investitori do të vendosë të bëjë një investim të njëhershëm në Fond, tarifa e hyrjes do të përcaktohet sipas tabelës në piken 10.a si më lartë.
Nëse investitori nuk e përcakton në dokumentin "Kërkesë për Blerjen e Kuotave" shumën e planifikuar të investimit, atëherë plani do të konsiderohet i hapur dhe mbi çdo pagesë të realizuar do të aplikohet tarifë hyrëse.
Shuma minimale për blerjen e kuotave nëpërmjet investimit të njëhershëm është 100 EUR.

Tarifa e hyrjes llogaritet në zbatim të formulës në vijim:

*Tarifa e hyrëse = shuma totale e investimit * tarifa e hyrjes (%)*

Shembull: Në qoftë se një person investon 15.000 euro si investim të vetëm, sipas tabelës tarifa e hyrjes do të jetë 4,5% nga investimi, përkatësisht 675 euro.

Nëse investitori vendos të investojë sërish në Fond, pagesat e mëparshme do të merren parasysh gjatë përllogaritjes së tarifës hyrëse për pagesat e ardhshme.
Në rast të shlyerjes së kuotave, investitori nuk ka të drejtë të kërkojë kthim të tarifës hyrëse të paguar.

11.2 Plani i Programuar

Investitorët mund ta zgjedhin Planin e programuar të pagesave, d.m.th. të investojnë mbi bazë të pagesave të barabarta vjetore, gjashtë mujore, tremujore dhe mujore. Plani i programuar lidhet me afatin kohor prej minimumi 10 vjet deri në afat të pacaktuar. Shuma minimale e pagesës vjetore është 250 Euro.

Investitorët gjatë pagesës së parë (kështit të parë vjetor) preferohet të paguajnë shumën e 2 (dy) kësteve vjetore nga Plani i Programuar.

Në rast kur investitori do të vendosë që pagesa vjetore të jetë më e madhe se 3.500 euro, plani i programuar mund të fillojë me pagesën e një kësti të vetëm për 1 vit.
Pagesat vjetore të përmendura mund të paguhen edhe në këste mujore, tremujore ose në 6 mujore.

Përqindja e tarifës hyrëse përcaktohet konform Tabelës 10.a. Investitori ka dy opsione (alternativa) lidhur me pagesën e tarifës hyrëse:

1. Gjatë krijimit të Planit të Programuar, investitori mund të përfitojë tarifë hyrëse më të favorshme, në varësi të shumës totale të planit të investimit të programuar.

   Në këtë rast tarifa hyrëse përllogaritet sipas formulës në vijim:

*Tarifa hyrëse = shuma totale e planit të investimit * tarifa e* hyrëse *(%)*

Shembull: Investitori i cili do të vendosë të investojë 26.000 euro gjatë një periudhe prej 25 vitesh me pagesa të barabarta vjetore nga 1.000 euro (*pagesa e parë preferohet të jetë një minimum prej 2.000 euro*), tarifa hyrëse do të përllogaritet si 4% e vlerës totale e planit të investimit të programuar, përkatësisht 1.040 euro.

2. Gjithashtu, investitori mund të paguajë tarifë hyrëse vetëm në bazë të shumës së investuar/paguar të çdo kësti, dhe jo në bazë të vlerës totale të planit të investimit të programuar.

   Në këtë rast tarifa hyrëse përllogaritet sipas formulës në vijim:

*Tarifa hyrëse = shuma e investuar/paguar * tarifa e* hyrëse *(%)*

Shembull: Investitori i cili do të vendosë të investojë 26.000 euro gjatë një periudhe prej 25 vitesh me pagesa të barabarta vjetore nga 1.000 euro (*pagesa e parë preferohet të jetë një minimum prej 2.000 euro*), nëse pagesa e parë do të jetë në vlerën 2.000 Euro, tarifa hyrëse do të përllogaritet si 5% e vlerës së investimit të paguar, përkatësisht 100 euro.

Kjo tarifë paguhet njëkohësisht me pagesën e parë dhe nuk përfshihet në asetet e Fondit.

Pagesat e mëparshme do të merren parasysh gjatë përllogaritjes së tarifës hyrëse për pagesat e ardhshme.

Kërkesa për blerje kuotash, tek Plani i programuar dorëzohet vetëm një herë, gjatë pagesës së parë të aseteve për aktivizimin e planit.

Plani i programuar përfundon kur Investitori do të paguajë në total të gjithë shumën e parashikuar në planin e tij të investimit

Në rast të ndërprerjes së planit, investitori nuk ka të drejtë të kërkojë kthim të tarifës hyrëse të paguar.

11.3 Plani i Kombinuar

Plani i kombinuar paraqet planin e veçantë i cili mundëson kombinim të pagesës së njëhershme dhe të planit të programuar. Plani lidhet për një periudhë kohore prej minimum 10 vjet. Plani përbëhet nga pagesa e njëhershme dhe më tej vazhdon me pagesa te barabarta vjetore sipas intervalit te pagesave. Shuma minimale e pagesës vjetore është 250 Euro.

Pagesa e njëhershme me të cilën aktivizohet plani i kombinuar duhet të jetë më i madh ose i barabartë me (3) tre pagesa vjetore, por minimalisht 750 Euro.

Pagesat e ardhshme mund të paguhen edhe në këste mujore, tre mujore ose në gjashtë mujore.

Përqindja e tarifës hyrëse përcaktohet konform Tabelës 10.a. Investitori ka dy opsione (alternativa) lidhur me pagesën e tarifës hyrëse:

1. Gjatë krijimit të Planit të Kombinuar, investitori mund të përfitojë tarifë hyrëse më të favorshme, në varësi të shumës totale të planit të investimit. Tarifa hyrëse do të përcaktohet në bazë të shumës totale të pagesave të planifikuara dhe pagesës së njëherëshme,

   Në këtë rast tarifa hyrëse përllogaritet sipas formulës në vijim:

*Tarifa hyrëse = shuma totale e planit të investimit * tarifa e* hyrëse *(%)*

Shembull: Investitori i cili do të vendosë të investojë duke bërë një pagesë të njëhershme prej 10.000 euro dhe më pas brenda një periudhe prej 20 vitesh pagesa vjetore të barabarta prej 2.000 euro në vit, në total do të planifikojë të investojë 50.000 euro. Në këtë rast tarifa hyrëse do të përllogaritet si 3,5% e vlerës së investimit, përkatësisht 1.750 euro.

2. Gjithashtu, investitori mund të paguajë tarifë hyrëse vetëm në bazë të shumës së investuar/paguar, dhe jo në bazë të vlerës totale të planit të investimit.

   Në këtë rast tarifa hyrëse përllogaritet sipas formulës në vijim:

*Tarifa hyrëse = shuma e investuar/paguar * tarifa e* hyrëse *(%)*

Shembull: Investitori i cili do të vendosë të investojë duke bërë një pagesë të njëhershme prej 10.000 euro dhe më pas brenda një periudhe prej 20 vitesh pagesa vjetore të barabarta prej 2.000 euro në vit, në total do të planifikojë të investojë 50.000 euro. Në këtë rast tarifa hyrëse do të përllogaritet si 5% e vlerës së investimit të paguar, përkatësisht 500 euro.

Kjo tarifë paguhet njëkohësisht me pagesën e parë dhe nuk përfshihet në asetet e Fondit.

Pagesat e mëparshme do të merren parasysh gjatë përllogaritjes së tarifës hyrëse për pagesat e ardhshme.

Kërkesa për blerje kuotash, tek Plani i Kombinuar dorëzohet vetëm një herë, gjatë pagesës së parë të aseteve për aktivizimin e planit.

Plani i Kombinuar përfundon kur investitori do të paguajë në total të gjithë shumën e parashikuar në planin e investimit. .

Në rast të ndërprerjes së planit, investitori nuk ka të drejtë të kërkojë kthim të tarifës hyrëse të paguar.

11.4 Plani Investim +

Plani i Investim + paraqet kontratë blerje të kuotave në Fond në emër dhe për llogari të një pale të tretë, i cili me përfshirjen në këtë plan bëhet mbajtës i kuotave të Fondit, përkatësisht shfrytëzues i fundit.

Kjo kontratë lidhet ndërmjet subjektit juridik punëdhënës, shoqatës së punëdhënësve, shoqatës profesionale, sindikatave, shoqatave të qytetarëve, apo forma të tjera të organizimit. Në bazë të kësaj kontrate Organizatori detyrohet të paguajë një shumë të caktuar parash për blerjen e kuotave në fondin në emër dhe për llogari të shfrytëzuesit të fundit.
Shoqata është e detyruar që t'i investojë mjetet e paguara në përputhje me Ligjin dhe këte Prospekt me qëllim realizimin e përfitimeve dhe minimizimin e rrezikut nga investimi.

Kërkesa për blerje, tek Plani Investim + dorëzohet vetëm një herë, gjatë pagesës së parë të aseteve për aktivizimin e planit.

Pagesa e parë pas planit të investimeve kryhen në nivel vjetor. Pagesat e ardhshme vjetore mund të paguhen në muaj, në tremujorë dhe gjashtë mujorë.

Shuma minimale për blerjen e kuotave nëpërmjet pagesës të planit investues është 10 Euro.

Organizatori është i detyruar të njoftojë Shoqërinë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, marrëdhënies së biznesit, ose përfundimin e të gjitha pagesave të ardhshme në llogarinë e kujtdo qoftë anëtari, në çfarëdo llojë baze. Anëtari i planit të investimeve të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punësimit, marrëdhënia e biznesit, si anëtar përfaqësues të organizatorit, mund të mbetet në Fond ose të aplikojë për blerje të kuotave të pjesshme ose të plota në pajtim me Rregulloren dhe Prospektin e Fondit.
Tarifa e hyrjes për dhënien e kuotave të pagesave sipas planit të investimeve llogaritet dhe paguhet me pagesën e parë për të gjithë shumën e kontratës për të investuar, me të cilën organizatori i planit të investimeve mund të fitojë kushte më të favorshme për blerjen e kuotave në varësi nga sasia e shumës së përgjithshme të rënë dakord në planin e investimeve, dhe në përputhje me tabelën në pikën 10.a.

11.5 Përjashtime nga Tarifa Hyrëse

Shoqëria mund të zvogëlojë ose të përjashtojë nga pagesa e tarifës hyrëse në rast se punohet për investitorë të rëndësishëm, partnerë strategjikë si dhe kompani institucione financiare.

11.6 Këmbimi i kuotave

Mbajtësit e kuotave të një fondi investimi mund t'i këmbejnë ato me kuota të një fondi tjetër investimi, të manaxhuar nga e njëjta shoqëri administruese. Çdo investitor që dëshiron të këmbejë kuota në Fond, do të nënshkruajë një kërkesë për këmbim kuotash. Asnjë këmbim nuk do të kryhet gjatë periudhës kur e drejta e investitorëve për të kërkuar shlyerje të kuotave është pezulluar. Këmbimi i kuotave midis dy fondeve të investimit do të kryhet vetëm në një ditë pune kur të dy fondet kanë mundur të nxjerrin çmimet përkatëse të kuotave. Në rast të këmbimit të kuotave nga një fond në një tjetër do të paguhet tarifa e hyrjes në përputhje me Prospektin dhe rregulloren e Fondit në të cilin do të hyjë. Shoqëria mund të zvogëlojë ose të përjashtojë nga pagesa e tarifës hyrëse investitorin.

Efekti fiskal i këmbimit të kuotave është i njëjtë si në rastin e shitjes së tyre nga investitori (shlyerjes nga fondi).

11.7 Transferimi i pronësisë së kuotave në Fond

Transferimi i pronësisë së kuotave është i lejuar nga dokumenti themelues i fondit.

Çdo investitor në fondin e investimit ka të drejë të transferojë pronësinë e kuotave që zotëron nëpërmjet një akti transferimi të miratuar nga shoqëria administruese, në përputhje me parashikimet e neni 117 të ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" si dhe akte të tjera ligjore dhe rregullative.

Transferimi i pronësisë së kuotave është subjekt tatimi sipas legjislacionit në fuqi. Shoqëria administruese nuk do të aplikojë tarifë për tranferimin e pronësisë së kuotave në fond.

12. POLITIKA E SHPËRNDARJES DHE E PJESËMARRJES NË FITIMET E FONDIT

Kuotat e WVP GLOBAL janë kuota akumulimi, për të cilat të ardhurat nga investimi riinvestohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave.

13. MËNYRA DHE PROCEDURA E INFORMIMIT TË MBAJTËSIT TË KUOTAVE

Shoqëria i njofton mbajtësit e kuotave të Fondit për:

- Raportimet vjetore për punën e Fondit;
- Vlerat ditore neto të aseteve të Fondit;
- Çmimin e dhënies dhe blerjes së kuotave;
- Ndërprerjen e blerjes dhe pagesat e kuotave;
- Ndryshimet në rregulloren dhe prospektin e Fondit; dhe
- Informacione të tjera të përcaktuara në ligje dhe akte nënligjore.

Mbajtësit e kuotave gjithashtu mund të informohen në lidhje me çdo aspekt të punës së Fondit në mënyrat e mëposhtme:

- Në selinë e Shoqërisë;
- Në faqen e internetit të Shoqërisë;
- Media;
- Raportime On-line;
- Lajmërim me shkrim;
- Thirrje telefonike;

Procedura e informimit të mbajtësive të kuotave varet nga mënyra e zgjedhur e informimit.

Informacion pranë Selisë së Shoqërisë

Të gjitha informacionet në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë dhe Fondit, politikën e investimit, informacionet e publikuar nga mediat etj, mund të merren në selinë e Shoqërisë, Rruga "Barrikadave", Nr. 118, Kati 4, Ap. 1, Tiranë, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri 17:00.

Informacion në faqen e internetit të Shoqërisë

Informacionet në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë dhe Fondit janë gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të Shoqërisë: www.wvpfunds.al

Njoftime- On-line

Mbajtësit e kuotave mund të parashtrojnë pyetjet e tyre dhe të marrin përgjigje nëpërmjet postës elektronike. E-mail i shoqërisë është contact@wvpfunds.al

Nëse pyetjet e shtruara lidhen me dhënien e të dhënave të mbajtësit të kuotave të cilat janë personale, adresa e e-mail duhet patjetër të regjistrohet në databazën Shoqërisë si një adresë për korrespondencë.

Ndryshime thelbësore dhe përditësime në rregulloren dhe prospektin e Fondit

Në rast të sjelljes së vendimit për ndryshime dhe plotësime në Rregullore dhe Prospektin e Fondit, Shoqëria do të njoftojë të gjithë mbajtësit e kuotave të Fondit me mënyrën e marrjes së informacionit që ata vetë kanë zgjedhur, menjëherë pas miratimit të tyre, dhe para dorëzimit të kërkesës për miratim të ndryshimeve në Rregullore dhe Prospekt të Fondit deri në AMF.

Së bashku me dorëzimin e ndryshimeve dhe plotësimet e Rregullores dhe Prospektit të Fondit, Shoqëria do të njoftojë mbajtësit e kuotave në Fond që ato do të jenë efektive vetëm nëse janë miratuar nga AMF dhe pas publikimit të tij, si dhe mundësinë që ata kanë për tu tërhequr nga fondi para hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve.

14. NJOFTIM MBI PERFORMANCËN DHE STRUKTURËN E FONDIT, VENDI DHE MËNYRA E PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT

Performanca e Fondit mund të monitorohet çdo ditë nëpërmjet vlerës së kuotës, përkatësisht vlera neto e dhe çmimi për kuotë në Fond, publikuar në faqen e internetit të Shoqërisë. Informacioni mbi zhvillimin e Fondit, dhe strukturën e investimeve mund të merren në mënyrën dhe vendin siç përcaktohet në pikën 13.

15. TRAJTIMI FISKAL I FONDIT DHE MBAJTËSIT TË KUOTAVE

Fondi, për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aseteve, si dhe personi i fundit që përfiton prej saj, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin tatimor.
Të gjitha fitimet e realizuara nga investimi në Fond, do të tatohen vetëm në momentin kur shpërndahen tek investitori, sipas nr. 29/2023 “Për tatimin mbi te ardhurat”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

16. KOHËZGJATJA E VITIT FISKAL

Viti fiskal fillon nga 01 Janar deri në 31 Dhjetor.

II. INFORMACION MBI SHOQËRINË E ADMINISTRIMIT TË FONDEVE

17. FORMA LIGJORE

WVP Fund Management Tirana sh.a – Shoqëri Administruese e Fondeve të Investimit është një shoqëri aksionare, me seli Rruga "Barrikadave”, Nr. 118, Kati 4, Ap. 1, Tiranë, Shqipëri.

18. DATA E THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Shoqëria është themeluar në datë 24.01.2017

Shoqëria është themeluar për të ushtruar veprimtarinë e administrimit të fondeve të investimit, si dhe punë të tjera në përputhje me Statutin e Shoqërisë, Ligjin dhe rregulloret në zbatim të tij.

WVP Fund Management Tirana sh.a adminisitron fondet e mëposhtme:

1. Fondin e Investimit WVP Top Invest (Kodi FI-A1, datë 31.01.2018);
2. Fondin e Investimit WVP Global (Kodi FI-A2, datë 23.10.2020).

19. KAPITALI I SHOQËRISË, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë është: 28.600.000 Leke i cili përbëhet nga depozita.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë administruese është mbledhja dhe investimi i fondeve të Investimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut me qëllim jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit, por gjithashtu të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë administruese përfshin:

- administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- marketimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shitjen e kuotave të fondeve të investimit;
- kryerjen e detyrave administrative, që përfshijnë, ndër të tjera:
- mbajtjen e librave të llogarive kontabël dhe përgatitjen e raporteve financiare;
- përcaktimin e vlerës neto të aseteve dhe llogaritjen e çmimit të kuotës;
- përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë administruese me ligjet dhe rregulloret përkatëse;
- publikimet dhe raportimet për mbajtësit e kuotave;
- emetimin dhe shlyerjen e kuotave të fondeve të investimit me ofertë publike;
- është personi përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kuotave të fondit;
- mbajtjen e të dhënave në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- organizimin e seminareve informative dhe trajnime bazë mbi fondet e investimit për palët e interesuara;
- detyra të tjera të natyrës administrative, të miratuara nga AMF.

20. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Organet drejtuese të shoqërisë administruese janë: Asambleja e Aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratorët.

20.1 Asambleja e aksionarëve

Asambleja e aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesit ligjorë të aksionarëve të shoqërisë, si më poshtë:

- WVP Fund Management AD Shkup, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin maqedonas, përfaqsuar nga Z. Petar Andreevski, zotëron [49.5%] (dyzet e nëntë pikë pesë përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 6,435 aksione.
- WVP-Ndërmjetësim në Sigurime sh.a Tirana, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin shqiptar, përfaqësuar nga Znj. Valmira Tace, zotëron [25%] (njëzet e pesë përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 3,250 aksione.
- Z. Arton Lena shtetas austriak, zotëron [12.31%] (dymbëdhjetë pikë tridhjetë e një përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 1600 aksione.
- Z. Rupert Strobl shtetas austriak, zotëron [4%] ([katër përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 520 aksione.
- Z. Kujtim Ibraimi, shtetas maqedonas, zotëron [4,69%] ([katër pikë gjashtëdhjetë e nëntë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë ose 610 aksione.
- Z. Ardian Kelmendi, shtetas austriak, zotëron [2.5%] (dy pikë pesë përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë ose 325 aksione.
- Znj Vjollca Mirashi, shtetase shqiptare, zotëron [2%] (dy përqind) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë ose 260 aksione.

20.2 Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit është organi qëndror i shoqërisë administruese i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese. Ai kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat financiare të investimit, prospektet e fondeve nën administrim etj.
Këshilli përbëhet nga pesë anëtarë si më poshtë:

- Rupert Strobl - Kryetar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv
- Arton Lena – Anëtar i Këshillit të Administrimit, Drejtor Ekzekutiv/Administrator
- Arjola Shegani - Anëtare e Këshillit të Administrimit, Anëtar Ekzekutiv/Zv. Administrator
- Ardian Kelmendi - Anëtar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv
- Fatos Kaleshi - Anëtar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv

MAG Rupert Strobl - Kryetar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv

MAG Rupert Strobl ka karrierë të gjatë në industrinë e menaxhimit të aseteve financiare prej vitit 1996. Magjistër i studimeve Sociale dhe Ekonomike në Universitetin e Graz-it. Prej vitit 1989 mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të WVP Group Austria -WVP Versicherungsvermittlung Gmbh Graz. Ka një eskperiencë dhe përvojë mbi 25 vite në fushën e investimeve, si dhe është përgjegjës për politikën e investimit të fondit privat të investimeve WVP Invest Vermögensverwaltung Gmbh&Co.KEG prej viti 1996.

Mag. Rupert Strobl përfaqëson Këshillin e Administrimit të shoqërive që menaxhojnë fondet e investimeve në rajon dhe me gjerë si Serbi, Maqedoni e Veriut, Bosnjë, Shqipëri, Kroaci, Mal i Zi, Ukrainë, Moldavi, Bullgari dhe Austri.

Z. Rupert Strobl është Drejtor i Përgjithshëm i WVP Group Austria- WVP Versicherungsvermittlung Gmbh Graz, Austri.

MAG Arton Lena - Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë:

MAG Arton Lena është aktualisht Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë Administruese WVP Fund Management Tirana sh.a. Z. Lena ka një eksperiencë të gjerë mbi 15 vite në fushën e industrisë financiare, në menaxhimin e portofoleve, investimeve,

shitjes të produkteve financiare dhe atë të sigurimeve. Z. Lena zotëron diplomë universitare Master në Biznes Ndërkombëtar, në Universitetin e Vjenës, Austri, si dhe posedon diplomë për këshilltar financiar dhe Broker nga Akademia e Bursës në Vjenë, Licencë për tregtim në sistemin elektronik të Bursave Europiane XETRA, Licencë për Agjent sigurimesh dhe Këshilltar Financiar në Vjenë, Austri, Ekspert i Licencuar për Bashkimin Evropian (CIFE) Nizza, Francë. Në vitin 2008 ishte një ndër themeluesit të shtëpisë broker për tituj Eurohaus AD Shkup, anëtare në Bursën e Maqedonisë së Veriut, ku deri në vitin 2010 ishte Menaxher perfaqësues për rajonin Gjermanofolës.

Prej vitit 2010 deri në vitin 2011 ai ka punuar në Hedge fondin kanadez, ku fitoi njohuri profesionale nga fusha e investimeve dhe analiza teknike e titujve në bursat botërore. Në vitin 2014 themelon WVP Fund Managment AD Shkup dhe merr funksionin e Chief Investment Manager, përgjegjës për politikën investuese të katër fondeve të investimit.

Z. Arton Lena është anëtar ekzekutiv i Këshillit të Administrimit të WVP Pension sh.a Shkup, në Maqedoninë e Veriut.

Arjola Shegani - Anëtare e Këshillit të Administrimit, Anëtar Ekzekutiv/Zv. Administrator

Znj. Arjola Shegani është aktualisht Drejtor Back Office, si dhe zv. Administrator i Shoqërisë Administruese WVP Fund Management Tirana sh.a. Znj. Shegani ka kryer studimet në fushën e Administrimit të Biznesit pranë Fakultetit Ekonomik Tiranë. Ka një eksperiencë të gjatë në sektorin privat në administrimin e biznesit, nga të cilat mbi 6 vite në fushën e investimeve prej viti 2018 kur u bë dhe pjesë e kësaj shoqërie.

Qershor 2021 ka kryer specializimin pranë Universitetit të Gjenevës mbi Menaxhimin e Investimeve (distance e-learning).

Znj. Arjola Shegani nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

Ardian Kelmendi - Anëtar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv

Z. Ardian Kelmendi prej vitit 2003 e në vazhdim, mban pozicionin e Menaxherit të Rajonit në Shqipëri dhe Kosovë pranë WVP- Versicherungs- Vermittlungs- GmbH në Graz. Z. Kelmendi zotëron diplomë universitare në Universitetin e Graz-it, Austri “Karl-Franzens”, Instituti për përkthime. Ai ka kryer më pas specializimin në Industrinë e Sigurimeve pranë Universitetit të Grazit, “Karl-Franzens” Austri.

Z. Ardian Kelmendi nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

Fatos Kaleshi - Anëtar i Këshillit të Administrimit, Anëtar jo Ekzekutiv

Z. Fatos Kaleshi karrierën e tij profesionale e ka filluar si konsulent ligjor në disa zyra ligjore, me përvojë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Magjistër në Drejtësi në Universitetin e Bolonjës, Itali. Pas diplomimit si ‘Dottore Magistrale’, z. Kaleshi ka kryer edhe disa trajnime dhe kurse pas Universitare pranë Universitetit të Bolonjës në fushën tregtare. Duke filluar nga viti 2012 z. Kaleshi është anëtar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Pas disa përvojave si konsulent ligjor pranë zyrave ligjore dhe marrjes së liçensës së Avokatit, përvoja profesionale e z. Kaleshi vijon prej më shumë se 13 vjet si konsulent ligjor pranë shoqërive tregtare. Prej më shumë se 10 vite z. Kaleshi ka drejtuar departamentin ligjor në disa nga kompanitë më të mëdha tregtare në Shqipëri. Përvojën e tij profesionale z. Kaleshi e ushqen gjithashtu me kërkime dhe shkrime akademike si dhe e ndan nëpërmjet trajnimeve, si lektor, në organizata, kryesisht vullnetarizëm, në promovimin e një kulture profesionale evropiane mes juristëve duke i përgatitur ata të veprojnë, të mendojnë dhe të sillen në përputhje me vlerat dhe parimet më të larta të profesionit.

Z. Fatos Kaleshi nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

20.3 Personeli kyç i shoqërisë

Emrat dhe postet e personelit kyc të shoqërisë janë si më poshtë:

- Znj. Andrijana Popovksa – Drejtor, Departamenti Menaxhimit të Riskut te grupacionit WVP Fund Management, nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.
- Znj. Arjola Shegani – Drejtor, Departamenti Backoffice, nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.
- Z. Fatos Kaleshi – Drejtor, Departamenti i Përputhshmërisë, nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

21. INFORMACION MBI AKTIVITETET E SHOQËRISË

Në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", Shoqëria ushtron aktivitetin mbi themelimin dhe administrimin e fondeve të investimit.

22. AUDITUESI

Audituesi i jashtëm i Fondit është Grant Thornton Albania sh.p.k me seli në adresën: Rruga "Brigada 8", Pallati Nr.19, Kati 0, Nr.3, Tiranë, Shqipëri.

Personat përgjegjës:
Kledian Kodra (Partner)
Esmeralda Gjomemo (Partner)

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

23. INFORMACION MBI DEPOZITARIN

Shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Bankën First Investment Bank – Albania sh.a., me seli në Bulevardin "Deshmorët e Kombit", Twin Towers, Kulla 2, Kati 14. Depozitari është licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit me Vendimin nr.13 datë 10.03.2010 si dhe licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për fondet e investimeve me Vendimin nr. 175, datë 13.12.2011.

Veprimtaria e mbajtjes së aseteve dhe veprimtari të tjera, të zhvilluara nga depozitari, për shoqërinë administruese, për sa i përket strukturës organizative, veçohen nga veprimtaria e shoqërisë administruese. Asetet e Fondit, përfshirë llogaritë bankare dhe asete të tjera, ruhen dhe mbahen nga depozitari në një llogari të posaçme dhe nuk mund të përdoren as drejtpërdrejtë, as në mënyrë të tërthortë për kryerjen e transaksioneve për llogari të tij, ose për të marrë ndonjë përfitim për vete a punonjësit e tij, apo për qëllime të tjera, përveç përfitimit të mbajtësve të kuotave. Asetet e Fondit që mbahen nga depozitari, kanë të drejtën e veçimit, si dhe nuk përfshihen në asetet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, të nisura sipas legjislacionit shqiptar dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj depozitarit. Depozitari vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave të Fondit.
Depozitari do t'i delegojë sherbimet e kujdestarisë, First Financial Brokerage House Sofia në lidhje me transaksionet e letrave me vlerë.
Shoqëria WVP Fund Management Tirana ka një marrëveshje me First Investment Bank – Albania sh.a për kryerjen e shërbimeve të depozitarit për të gjithë Fondet që shoqëria do të ketë në administrim.

Përveç ruajtjes së aseteve të Fondit, depozitari kryen edhe veprimtaritë e mëposhtme:

- garanton se shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave janë në përputhje me ligjin dhe aktin themelues të sipërmarrjes;
- siguron se vlera neto e aktiveve të kuotave është llogaritur në në përputhje me ligjin dhe aktin themelues të sipërmarrjes;
- përmbush dhe zbaton udhëzimet e shoqërisë administruese nëse nuk bien ndesh me ligjin, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të ligjit ose me aktin themelues të sipërmarrjes;
- garanton kthimin e çdo shume përkatëse sipërmarrjes, brenda afateve kohore të përcaktuara lidhur me transaksionet që përfshijnë aktivet e fondit;
- garanton se të ardhurat e fondit përdoren në përputhje me ligjin dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;
- garanton që flukset monetare të fondit monitorohen si duhet, në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga investitorët, ose në emër të investitorëve, me nënshkrimin e kuotave të fondit dhe se të gjitha mjetet monetare të Fondit janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të Fondit, shoqërisë adminstruese për llogari të Fondit ose depozitarit për llogari të Fondit;
- lidhur me llogaritë e hapura, në bazë të paragrafit më sipër, depozitari merr masat e nevojshme për të siguruar që fondet e sipërmarrjes të depozituara pranë një banke qëndrore, një banke në Republikën e Shqipërisë apo një banke të licencuar në një vend tjetër mbahen në një llogari ose disa llogari të identifikuara më vete nga çdo llogari e përdorur për të mbajtur fondet që i përkasin depozitarit apo fondeve a klientëve të tjerë të depozitarit;
- kur llogaritë monetare hapen në emër të depozitarit, i cili vepron për llogari të Fondit, në këto llogari nuk kontabilizohet asnjë mjet monetar i veti i depozitarit apo i subjekteve të përmendura në paragrafin më sipër;
- emeton e anulon kuotat e Fondit dhe paguan paratë e shlyerjes mbajtësve të kuotave, sipas udhëzimeve të shoqërisë administruese, kur këto udhëzime janë në përputhje me ligjin dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij;
- është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të mbajtësve të kuotave dhe shërbimet e transferimit për fondet e investimeve me ofertë publike, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese, në lidhje me këtë regjistër, është në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- i raporton shoqërisë administruese të fondeve për veprimet tregtare lidhur me aktivet e sipërmarrjes së mbajtura në kujdestari dhe ekzekuton udhëzimet e saj;
- njofton autoritetin me shkrim, menjëherë nëse pas një shqyrtimi të fakteve që ka në dispozicion ose të rrethanave, ka arsye për të besuar se shoqëria adminstruese e fondeve ka shkelur dispozitat e ligjit ose të prospektit dhe rregullave të fondit;
- mban përgjegjësi ndaj sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe ndaj mbajtësve të kuotave për çdo humbje të shkaktuar nga depozitari ose nga një palë e tretë, së cilës i është deleguar ose nëndeleguar kujdestaria e instrumenteve financiare të mbajtura në kujdestari;
- Në rastin e humbjes së instrumentit financiar të mbajtur në kujdestari, depozitari garanton kthimin e instrumentit financiar të një lloji identik ose shumën korresponduese sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike. Depozitari nuk mban përgjegjësi nëse vërteton se kjo humbje ka ndodhur si rezultat i rrethanave që janë jashtë kontrollit të depozitarit, pasojat e të cilave do të kishin qenë të pashmangshme pavarësisht nga të gjitha përpjekjet për shmangien e tyre

Depozitari nuk kryen veprimtari lidhur me Fondin ose me shoqërine administruese që adminsitron fondin, të cilat mund të shkaktojnë konflikt interesi ndërmjet Fondit, investitorëve të fondit, shoqërisë adminstruese dhe vetë depozitarit, me përjashtim të rastit kur depozitari ka bërë një ndarje funksionale dhe hierarkike të kryerjes së detyrave të depozitarit nga detyrat e tjera që përbëjnë konflikt dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme dhe u bëhet e ditur investiotorëve të Fondit. Depozitari nuk zotëron licencë si shoqëri adminitruese.

Kur Depozitari i Fondit kryen transaksione me subjekte të lidhura ose persona fizikë të lidhur vendos në zbatim politika dhe procedura të cilat garantojnë se: a) identifikohen të gjith konfliktet e interesit të lindura nga këto transaksione; b) ndërmerren të gjitha hapat e arsyeshme për t'i shmangur këto konflikte interesi. Kur mund të shmanget konflikti i interesit, shoqëria adminstruese dhe depozitari administrojnë, monitorojnë dhe bëjnë të ditur këtë konflikt interesi, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interesat e Fondit dhe investitorëve të tij.

24. DELEGIMI

Shoqëria WVP Fund Management, pjesë e WVP Group Austria në administrimin e investimit të fondit, do të shfrytëzojë eksperiencën shumëvjeçare të shoqërisë mëmë, si dhe standartin e ushtrimit të veprimtarisë së saj në mbi 30 vite. Me qëllim rritjen e efiçencës si dhe për të vepruar në interesin më të mirë të investitorëve, shoqëria do të delegojë funksionimin e disa pjesëve të veprimtarisë së saj te WVP Group Austria, por ajo vazhdon të jetë përgjegjëse për funksionet e deleguara dhe mbarëvajtjen e tyre. Shoqëria do të caktojë personat përgjegjës të cilët do të shkëmbejnë informacione dhe do të përshtatin procedurat me ligjin dhe rregulloret në Republikën e Shqipërisë.

Ne bazë të kontratës së lidhur midis shoqërisë administruese dhe WVP Group Austria, do të delegohen funksionet si më poshtë:

- Marketingu: zhvillon dhe implementon strategjinë e marketingut të shoqërise administruese, siguron mbështetjen e duhur të promovimit të imazhit në përputhje me standartet e Grupit, si dhe mban marrëdhëniet me palët e treta që ofrojnë shërbime të Marketing-ut dhe Marrëdhënieve me Publikun
- Burimet njerëzore: mbështet shoqërinë administruese lidhur me politikat e trainimeve të punonjësve në përputhje me standartet e Grupit, si dhe politikat e brëndshme të saj (Manuali i Personelit, Kodi i sjelljes, si dhe programe te vazhdueshme trajnimi për te garantuar që të gjithë punonjësit te kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre)
- Administrimi i riskut: kryen funksionin e plotë në administrimin e risqeve nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të cilat sigurojnë përputhshmërinë e aktivitetit dhe procedurave me kuadrin ligjor dhe standartet e Grupit, si dhe identifikimin e problematikave dhe ekspozimin ndaj risqeve me qëllim përmirësimin e sistemit të riksut;

Shoqëria audituese kryen vlerësimin e kontabilitetit të fondit, auditimin e pasqyrave financiare duke përshirë shënimet, shpjegimet dhe opinionin në mbajtjen e dokumentatcionit. Vlerëson përputhshmërinë e politikave kontabël të përdorura me standartet ndërkombëtare të kontabilitetit, etj.

Auditimi i brendshëm do t'i delegohet personit të specializuar për auditim të brendshëm në Republikën e Shqipërsie. Në koordinim me personelin përgjegjës të shoqërisë do kryen funksionin e plotë të auditimit të brendshëm nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të cilat sigurojnë përputhshmërinë e aktivitetit dhe procedurave, me kuadrin ligjor dhe standartet, si dhe identikfiimin e problematikave dhe ekspozimin ndaj risqeve me qëllim përmirësimin e sistemit të kontrolleve. Auditi i brëndshëm raporton në organet drejtuese të shoqërisë administruese.

Çdo palë e tretë që merr përsipër kryerjen e disa funksioneve të deleguara nga shoqëria administruese, është e detyruar të hartojë rregullore dhe procedura te brendshme për të shmangur konfliktet e interest si dhe të njoftojë shoqërinë për cdo konflikt që mund të shmanget.

III. INFORMACION PLOTËSUES

Informacioni në këtë Prospekt bazohet në ligj dhe në praktikat më të mira. Çdo person që lexon këtë Prospekt, duhet të verifikojë me WVP Fund Management Tirana Sh.a. se ky është versioni më i fundit dhe se nuk janë bërë rishikime apo ndryshime të tjera që nga momenti që ky Prospekt ka dalë në qarkullim.

ETIKA DHE KONFLIKTI I INTERESIT

Punonjësit e përfshirë në procesin e investimit të aseteve nuk duhet të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal i cili mund të jetë në konflikt me menaxhimin e investimeve në mënyrën e duhur apo që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.

KUJDESI

WVP Fund Management Tirana sh.a do ta menaxhojë Fondin WVP GLOBAL me kujdes ku çdo investim duhet bërë me gjykim dhe maturi, në të njëjtat rrethana kur një person i kujdesshëm, do të ushtronte me zgjuarsi dhe pjekuri

administrimin e pasurive të veta, jo për spekullim, por për investim, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.
Fondi do të menaxhohet me profesionalizëm të denjë për besimin e publikut.

ANKESAT

Nëse keni një ankesë, ju lutem dërgojeni me shkrim në adresën e shoqërisë administruese, Rruga "Barrikadave", Nr. 118, Kati 4, Ap. 1, Tiranë. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe, do t'u jepet përgjigje brenda 20 ditëve punë pas pranimit të tyre.

STATUSI "FATCA"

Bazuar në Ligjin për Përputhshmërinë e Taksës mbi Llogarinë e Huaj – FATCA, nuk jemi në përputhje me Statusin FATCA. Shoqëria nuk do të pranojë në fond investitorë që janë shtetas të SHBA-së.

SHKËMBIMI AUTOMATIK I INFORMACIONIT TË LLOGARIVE FINANCIARE

Në kuadër të zbatimit të ligjit Nr. 4/2020, datë 30.01.2020, për "Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare", WVP Fund Management Tirana sh.a është e angazhuar në përmbushjen e dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra ne funksion të tij.

DATA E DHËNIES SË PROSPEKTIT

Ky është versioni i fundit i prospektit të fondit të investimit WVP Global, i publikuar më datë 10.11.2026.

IV. FORMULARI TIP-KËRKESË PËR BLERJEN E KUOTAVE

WVP GLOBAL

Rr. Barrikadave, Nr.118 / Kati 4, Apt. 1, 1000 Tiranë, Shqipëri
www.wvpfunds.al
info@wvpfunds.al

WVP FUND MANAGEMENT

KËRKESË PËR BLERJEN E KUOTAVE

Shoqëria për Administrimin e Fondeve Investuese WVP Fund Management Tirana SH.A

PËRFAQËSUESI / AGJENTI I SHOQËRISË

Emër, Mbiemër

Numri i bashkëpuntorit

Deklaratë: Deklaroj se e kam njoftuar investitorin me përmbajtjen e Prospektit të fondit. Identitetin e tij e vërtetova me kontrollin e dokumentit personal për identifikim.

Firmë

Nr. i regjistrit

TË DHËNAT E INVESTITORIT

☐ Person Fizik ☐ Person Juridik

☐ Rezident ☐ Jorezident

Emër, Mbiemër

Atësia

Nr. Per.

Data e lindjes

Nr. ID / Pas

Vlen deri

Lëshuar nga

Emri i personit juridik

NIPT

Llogaria Bankare

Banka

Numri i indetifikimit Bankar **BIC**, ose **SWIFT**

Informacione per Kontakt

Adresa / Selia

Nr. Postal

e-mail

Tel

Celulari

PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR

☐ Përfaqësuesi Ligjor ☐ Personi i autorizuar

☐ Rezident ☐ Jorezident

Emër, Mbiemër

Nr. Per.

Nr. ID/Pas

Vlen deri

Lëshuar nga

Instruksione për Pagesë:

Emri i Fondit:	**WVP GLOBAL**
Banka:	**First Investment Bank Albania**
IBAN:	**XXXX XXXX XXXX XXXX**
SWIFT:	**XXXXXX**
Intermediate Bank:	**XXXXXX** Ref.No. : **WVP Global**

Informacionet dua ti marr me: ☐ Poste ☐ E-mail

DEKLARATA E INVESTITORIT: Me nënshkrimin e këtij dokumenti unë marr pjesë dhe blej kuota në fondin e investimit WVP Global. Pranoj që të dhënat e mia personale të përpunohen, ruhen dhe shpërndahen vetëm për nevojat e Fondit dhe Shoqërisë, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, deri në tërheqjen me shkrim nga ana ime. Deklaroj se më është dhënë Prospekti i Fondit dhe jam njohur me përmbajtjen e tij, kam kuptuar kushtet dhe risqet e investimit të përfshira në fond. Unë pajtohem që fitimi nga kuotat në Fond, shoqëria t'i riinvestoj automatikisht në Fond. Të drejtën për të realizuar fitime mund ta kryej nëpërmjet shitjes të kuotave. Deklaroj se të gjitha të dhënat në këtë Dokument janë të vërteta. Unë marr përsipër në qoftë se në të ardhmen ndodh një ndryshim në disa prej të dhënave të përfshira në këtë dokument, të informojë në kohë shoqërinë për administrimin e fondeve të investimit WVP Fund Management Tirana SH.A

SHËNIM: Kuotat mund të blihen vetëm me transfertë në llogari bankare. Çmimi për shitjen e kuotave të reja është e barabartë me vlerën neto të aseteve të Fondit për kuotë. Shitja e kuotave të Fondit do të bëhet me një çmim i cili është përcaktuar në datën e pagesës në llogarinë e Fondit, në përputhje me Prospektin dhe Rregulloren e Fondit.
Nëse pagesa për blerjen e kuotave bëhet gjatë ditës (t) deri në orën 24:00, atëhere investitori blen kuota sipas vlerës së kuotës në ditën (t) me vlerë të panjohur. Për pagesat e bëra pas orës 24:00, kuotat blihen sipas vlerës së kuotës individuale të ditës tjetër (t+1), gjithashtu me vlerë të panjohur.

- Investimi në sipërmarrjen e investimeve kolektive nuk është një investim i garantuar
- Rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori
- Kuotat/aksionet e sipërmarrjes së investimeve kolektive nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave
- Sipërmarrja e investimeve kolektive nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetit të vlerës neto të aseteve

☐ PLANI I PROGRAMUAR

Kohëzgjatja në vite

Shuma TOTALE e planifikuar për të investuar

EUR

Shuma e investimit Vjetor

EUR

Dinamika e pagesave të tjera ☐ 1/12 ☐ 1/4 ☐ 1/2 ☐ 1/1

☐ PLANI I KOMBINUAR

Kohëzgjatje në vite

Pagesa e njëherëshme

EUR

Shuma TOTALE e planifikuar për të investuar

EUR

Shuma e investimit Vjetor

EUR

Dinamika e pagesave të tjera ☐ 1/12 ☐ 1/4 ☐ 1/2 ☐ 1/1

☐ PAGESË E NJËHERËSHME

Shuma

EUR

Nënshkrim i Investitorit/ Personit te Autorizuar
Për personat juridik Vulë dhe Nënshkrim i përfaqësuesit